

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME SAMIR SEZAIRIN

Beograd | Data: 28 qershor, 2017

Kohëzgjatja: 100 minuta

Të pranishën:

- Samir Sezairi (I intervistuari)
- Marijana Toma (Intervistuesja)
- Boris Shebez (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Marijana Toma: Po fillojmë intervistën, 28 qershor të vitit 2017. Unë do të ju kisha lutur që sa për fillim të na prezantoheni, pra, na e thuani emrin, mbiemrin dhe vendin ku jeni lindur, data dhe vendi i lindjes?

Samir Sezairi: Emri im është Samir Sezairi, i lindur me 24 shkurt të vitit 1986 në Prishtinë, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë.

Marijana Toma: A mund të na tregoni diçka më shumë lidhur me familjen tuaj, do të thotë për familjen, për prindërit dhe në përgjithësi për vendin në të cilin keni lindur?

Samir Sezairi: Prindërit e mi gjithashtu janë të lindur në Kosovë. Kështu, ne ishim pesë anëtarë në një moment, do të thotë, kështu tre fëmijë, kjo ishte ideja e dikurshme e prindërve të mi për të pasur sa më shumë fëmijë dhe tani si të them, ne jemi tre fëmijë të rritur, të lindur në vitin '86, '89 dhe '99. Pra, njëri është djalë i rritur i cili ka mbushur 18 vjet dhe faktikisht do të regjistrohet në fakultet.

Babai dhe nëna u lindën dhe kanë jetuar në Kosovë, gjithashtu edhe prindërit e tyre. Ata janë me origjinë nga fshati, aty nga rrethi i Prizrenit. Nga një pjesë e Zhupës qendrore e cila gjindet në pjesën e sipërme të Prizrenit, aty sipër Dushanovës, aty pranë manastirit të vjetër Shën Arangjelit. Kështu që edhe kjo është një gjë që duhet përmendur. Babai im ka vdekur, tash u bënë tre vite prej vdekjes së tij, por nana jeton dhe sot është për ne edhe nënë edhe baba. Kështu pra, ja, këto janë disa, disa nga të dhënat e përgjithshme.

Kemi jetuar në Prishtinë. Unë jam i lindur në Prishtinë dhe kemi jetuar aty deri në vitin '99, deri në bombardimet e kobshme. Në një moment ne kemi kaluar për të jetuar në Shkup pasi që nëna, familjarët e nënës kanë jetuar në Shkup qysh prej viteve të '60-ta. Aty ne kishim njëfarë lloj baze të

vogël, si të themi, aty ne e kemi kryer një pjesë të shkollimit deri sa jemi kthyer, erdhëm në Beograd. Ndërsa babai im ishte gjithmonë në udhëtim në relacionin Prishtinë - Beograd, prej vitit '99.

Marijana Toma: A mund të më thuani diçka më tepër për familjen tuaj, prindërit tuaj dhe në fakt për jetën e tyre, prindërit e tyre, do të thotë në fakt për familjet e tyre duke marr parasysh se ata janë nga rrethi i Prizrenit dhe se ju keni mbiemër interesant. Mund të më thuani pak më shumë rreth këtyre rrethanave?

Samir Sezairi: Ah po, por mbiemrat tonë janë ndërruar. Ne e kemi historinë tonë. Unë jam njeri i cili, i cili, cili ka dëshirë të hulumtojë këto gjëra që janë pjesë e familjes tonë. Në të vërtetë, ky është një rreth i cili ishte dhe është shumë i varfër, aty njerëzit ishin më pak të ngritur dhe këto të dhëna lidhur me prejardhjen dhe mbiemërat e të tjera ekzistojnë në librat e kishës, sepse kisha ishte e vetmja që posedonte njerëz të dijshtëm, të cilët kanë njohur shkrimin, kanë ruajtur dhe evidentuar.

Mbiemri i jonë është Sezairi dhe vjen nga gjyshi apo katragjyshi të cilin e quanin Sezair, dhe se të gjithë këta mbiemra përcillen nga emrat e prindërve apo njerëzve tjerë nga e kaluara mund të themi në mes tjerash që ka evoluar. Unë kështu dëshiroj të them sepse mbiemri i im ishte Sezairoviq deri në një periudhë aty rreth viteve '60, '60 apo aty dikund, kur bukvalisht me dhunë kjo anë i ka shkurtuar mbiemrat nga Sezairoviq, ka mbet ky mbiemër Sezairi sepse njerëzit... Siç i quaj unë, ata njerëzit 'modern të turqizuar' sepse në njëfarë mënyre ishin të kushtëzuar ekonomikisht, për punësim dhe gjëra tjera prandaj kanë preferuar shkurtimin e asaj pjese të mbiemrit.

Viteve të '90-të njerëzit i kanë kthyer, i kanë kthyer ato mbiemrat e vjetër burimor. Madje edhe në familjen tonë disa i kanë kthyer mbiemërat burimor, përveç babait tim. Ai i ka më, ka edhe katër vëllezër, në mesin e tyre vetëm ne e kemi mbiemrin Sezairi, dhe unë nuk kam pasur dëshirë që tani edhe këtë mbiemër timin ta ndërroj sepse jam i bindur plotësisht se është gjë e parëndësishme se si dikush e ka mbiemrin, me e rëndësishme është se çfarë njeriu je, ky ka qenë përcaktimi im gjithmonë.

Pastaj, prindërit janë njoftuar sepse ata erdhën në moshë të re dhe e kanë vizituar atë pjesë që është shumë specifike, 1.500 - 600 metra në lartësi mbidetare. Përgjithësisht kjo ishte një formë tubimi përgjatë verës dhe e kanë bërë një lloj shëtitje verore. Dhe fare rastësisht edhe pse prindërit e tyre janë njohur edhe me parë sepse në mes tjerash njerëzit e gjyshit dhe të nanës kanë qenë nga i njefti fshat andaj si të tillë... Në të vërtetë, ata janë njohur në vegjëli, pastaj kah moshë 20 vjeçare ata u njohën dhe thjeshtë kanë vendosur për të jetuar së bashku.

Marijana Toma: Ata në Prizren, aty u njohën apo?

Samir Sezairi: Po, ata janë njohur në Prizren. Nëna ime është, nëna ime u shkollua në Shkup, ajo ka jetuar, ka lindur në Mal të Zi, pasi që gjyshi ka punuar dhe shkuar aty, mirëpo për shkak të termetit në vitin 1963 janë larguar nga Shkupi. Pasi që nëna në të vërtetë në vitin 1963, ajo ishte foshnje e vogël, i

ka pasur vetëm disa muaj kur ka ardhur në Shkup, por natyrisht çdo vit kanë shkuar për të vizituar gjyshen, gjyshin, e kanë vizituar fshatin dhe aty janë njohur. Kështu që... babai deri sa i mbushi 18 vite, jetonte në fshatin e babait të tij që quhet Planjan, pastaj edhe ai u shkollua në Prizren dhe më pas në Prishtinë është punësuar. Dhe aty ne kryesisht kemi jetuar.

Sa për mua, mendoj as që e kisha ndërruar Prishtinën. Këto gjëra vazhdimisht përpiqem të ua shpjegoj njerëzve, mirëpo sikur nuk ta kishim përjetuar atë situatë e cila ndodhi, ne më të vërtetë nuk kemi pasur arsye për ta ndërruar vendbanimin edhe Beogradi na ishte vetëm një opcion ku do të kishim ardhur ndonjëherë sa për turizëm apo sa për shopping sepse ai është qyteti më i madh i një shteti të madh siç është Serbia, gjegjësisht siç ishte Republika Federative e Jugosllavisë, ky është... i vetmi kujtim nga Beogradi është kur shkonim si turistë, takoheshim me miq dhe bënim shopping.

Përndryshe, Prishtina ishte plotësisht një qytet multikulturor me 300.000 banor, çdo gjë e kishte pranë dorës, pra kështu e mendoj unë atë qytet, kështu. Më ra në mend një tregim lidhur me një shokun tim. Po nga e njejta perspektivë sepse është nga perspektivat e një fëmiju, mua më dukej qytet jashtzakonisht i madh, por tani nga perspektiva e një njeriu të rritur që shkon dhe e viziton, sepse ai vjen shpesh e viziton Kosovën e Metohinë, që është ashtu një qytet ku ke çdo gjë afër dorës, për 15 minuta e ecë të tërin. Por nga perspektiva e një fëmiju ky ishte një qytet shumë i madh dhe shumë qytet serioz. Ashtu ishte atëherë.

Por ai tani është një qytet i madh, por për nga numri i popullsisë është rritur gati dyfish nëse e krahasojmë më periudhen e '99-tës, por sigurisht këto janë ndryshime të natyrshme se njerëzit jetojnë në qytetin më të madh dhe se më së shumti aty e bëjnë dendësimin e popullsisë, në atë qytet i cili është epiqendra i të gjitha ngjarjeve. Në këte rast a ka qenë Kosova e pavarur apo akoma Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, por ky është qyteti më i madh dhe qendër administrative e atij regjioni.

Marijana Toma: A më thuani këtë tani, ke filluar të flasësh, në të vërtetë, si ndihesh sot lidhur me Prishtinën? Ti je i lindur në vitin '86?

Samir Sezairi: '86.

Marijana Toma: Apo jo, ju ishit tre e tani a mund të më tregosh diçka, së pari në cilën pjesë të Prishtinës ke jetuar dhe pak më shumë na flisni për këtë, lidhur më fëmijërinë tuaj si dukej ajo dhe çfarë të ka lënë mbresa, të kujtohen ndonjëra nga erërat apo ngjyrat?

Samir Sezairi: Po ne kemi jetuar në atë pjesën e qytetit e cila quhet Ulpiana, ajo është afër Qendrës Spitalore, një spital i ri na e kishim shumë afër aty pesë minuta prej ndërtesës tonë, neve na ndante vetëm rruga apo bulevardi. Nëna ime gjithnjë vonohej për në punë, ajo punonte në spital. Ky është ai farë sindromi, sa më afër që je aq më shumë vonohesh. Por, vërtetë një fëmijëri interesante.

Ashtu, unë në ndërtesën tonë i kam pasur të gjitha, absolutisht çdo gjë. I kisha, mund, mund të kujtohem, e kam parasysh atë fotografi, në mendje dhe tani di të tregoj kush ku ka banuar. I di edhe mbiemrat e tyre, i di emrat dhe në cilën banesë kanë banuar, nuk e di, a kanë qenë serb, musliman apo turq, i kemi pasur absolutisht të gjitha, por thjeshtë ne jemi të pjekur me njëfarë ideje se, se, se neve na ishte ekzotike ajo prezenca e kulturave të shumta. Ne si fëmijë nuk e kemi ditur, mendoj neve politika dhe të gjitha të tjerat nuk na dukeshin interesante e as të rëndësishme, luajshim më kilikera, futboll apo symbyllurazi, hypnim nëpër drunjë dhe plotësisht ishte e parëndësishme se me kë je. Për neve ishte e rëndësishme, na e organizojshim ndonjë lloj loje dhe shoqëroheshim, por ndihej pak ajo pakënaqësia, të ta them kushtimisht. Sepse... mendoj se ato të gjitha barteshin nga shtëpia. Më kujtohen ato përjetime se shkolla ime ku kam shkuar unë ishte e ndarë. Shkolla ime quhej “Dositej Obradović”, deri ‘93 ishte shkolla fillore “Hasan Prishtina”. Eh shkolla fillore ku vijonim ne ishte e ndarë... bukvalisht, ishim të ndarë. Nuk jemi, nuk jemi përzier, nuk kishte...

Marijana Toma: Mendon me shqiptarë?

Samir Sezairi: E kam fjalën për shqiptarë dhe neve të tjerëve, thënë kushtimisht. Mendoj, nuk jemi përzier sepse ata i kishin dy katet e veta, e kishin edhe hyrjen e tyre, ne e kishim katin tonë dhe hyrjen tonë dhe thjeshtë nuk kishim përzierje fizike deri, deri aty kah viti ‘93, deri në atë kohë kjo shkollë e kishte emrin e përbashkët “Hasan Prishtina”.

Por, mendoj se këto të gjitha, këto lloj mosmarrëveshje, respekti edhe ajo kultura vijnë nga shtëpia dhe disa herë ka ndodhur, jo vetëm disa herë, por thjeshtë sa filloi të turbullohet gjendja politike, situata në Kosovë, kjo gjë është shprehur edhe tek të rinjtë, përkatësisht edhe te fëmijët gjë që nuk e kemi ditur. Ne në vitin ‘99 i kemi pasur dymbëdhjetë, trembëdhjetë vjet, që do të thotë në këtë periudhë ka pasur raste kah vitet ‘96, ‘97 ‘98 ne ishim të fëmijë, por ka pasur raste kur kanë sulmuar njëri tjetrin. E ne kemi shikuar si ngjarje argëtimi apo thjeshtë kjo ishte një shtytje...

Marijana Toma: E ke fjalën për fëmijët?

Samir Sezairi: Ashtu është, po. Fëmijët në mes veti. Por kjo është, mendoj se këto janë, se të gjitha këto informacione këta fëmijë i kanë marrë nëpër shtëpitë e tyre. Eh, ky është problem i madh. Përndryshe, unë jam, përvoja ime është shumë pozitive në çdo aspekt. Se ne ishim në mes të dy zjarreve. Thjeshtë ne jemi të padefinuar në këte kuptim, unë jam Samiri, flas gjuhën serbe dhe shkoj në shkollën serbe, ndoshta me ata i ndajmë motivet fetare, por nuk i ndaj traditat, zakonet, kulturën sepse ato i takojnë regjionit prej nga vijnë njerëzit e mi.

Ai ishte një mjedis i cili kishte qenë historikisht ortodoks, kryesisht ortodoks dhe kohë pas kohe ja, si ta them, nuk e di, pranimi i islamit e tjera e tjera, njerëzit i kanë... është ndërruar, struktura e banorëve, por gjithmonë ka qenë pjesa ku kanë jetuar, për shembull, serbët dhe muslimanët, ku është folur ajo

gjuhë specifike për ato vise ku kanë folur vetëm serbët dhe muslimanët të cilët e kanë ndarë traditën e njejtë, kulturën dhe zakonet, ditën e Shën Gjergjit. Por nuk ishin ato motive fetare, por motive zakonore në atë periudhë.

Kështu që, ne si fëmijë kemi qenë edhe këtu edhe atje. Në të vërtetë [nuk e di] a ishim ne të pranuar edhe këtu edhe atje, por edhe ajo përvojë për mua është e çmueshme, sepse për një moment kam përjetuar atë lloj pakënaqësie të cilën e kam mësuar që nuk duhet, jo që nuk duhesh të urresh, thjeshtë nuk e ke brenda, ke mirëkuptim për çdo njeri, sepse secili e ka një vuajtje, mundim, mërzi.

Unë e përjetova '99-tën pas bombardimeve, unë gjatë kohës së bombardimeve nuk isha në Prishtinë, isha në Shkup, për fatin tim nuk pata rast të, të, të pëcjelli të gjitha ato dhe për t'i përjetuar të gjitha ato trauma, sikur do kthehesha unë '99. Në një moment matanë rrugës, përballë ndërtesës sonë, diku 20 metra prej banesës tonë, meqë ne jetojmë ne katin e parë, aty ishte një dyqan i vogël të cilin e mbante një shqiptar, ai e ka pasur gjithmonë atë dyqan, thënë kushtimisht edhe para luftës e ka pasur atë dyqan.

Gabimi më i madh si fëmijë është që nuk e kemi mësuar atë gjuhë. Mendoj që, që, që gjuha është pasuri, nga perspektiva e një 30 vjeçari e konsideroj që ky është gabimi im më i madh. Babai im e ka mësuar duke punuar me ata edhe vërtetë e ka njohur shumë mirë, por e ka mësuar sepse e ka shtyer nevoja, apo. Edhe ne si fëmijë kemi pasur mundësi ta mësojmë. Mendoj, ne i dijmë afër 20 fjalë apo 30, ato kryesisht janë për ndonjë, ndonjë komunikim elementar, por ne kemi pasur mundësi për ta mësuar më shumë.

Thjeshtë mendoj se, se, se urrejtjen e kemi ndaj asaj gjuhe sepse nga gjithë kjo, nga gjithë ky konstrukcion ngjarjesh se, se shqiptarët janë popull i ulët, se janë të papastër dhe se janë të tillë e të atillë, thjeshtë janë nga kjo, thjeshtë janë disa paragjykime, të pabazuara, paragjykime ndaj njerëzve, e ne si fëmijë, të cilët gjatë gjithë ditës rrinim në rrugë, të gjitha këto informata i përqafoam, thjeshtë ne e kemi pasur një ngarkesë ndaj kësaj gjuhe e edhe ne kemi pasur mundësi për të mësuar pa asnjë problem siç e mësuan ata.

Ata ishin 90 përqind në territorin e gjithë Kosovës, pjesa dërmuese e popullsisë së Prishtinës, e çdonjëri shitës i dyqaneve të tyre i cili mbase i ka pas katër vite të shkollës fillore e hajt mbase edhe shkollën fillore, ata e kanë njohur dhe përdorur gjuhën serbe të mjaftushme për komunikim, sepse ai ka qenë tregtar edhe ai e ka kuptuar se ajo gjuhë i nevojitet atij. E në të vërtetë ata kanë përfaqësuar 90 përqind të popullsisë, do të thoja kushtimisht, nuk kanë pasur nevojë por megjithatë ata e kanë njohur. Kështu që, gabimi i jonë më i madh dhe i shumicës më të madhe të asaj gjenerate dhe disa gjenerateve para meje, hajde të themi se këta pas meje kanë qenë shumë të ri, apo ende të ri, por gjenerata e cila '82, '83 apo '80, madje më së shumti deri në '86- '87 kanë gabuar që nuk e kanë mësuar gjuhën, e veçanërisht këtë gjuhë që vërtetë është një lloj gjuhe apo një pasuri të themi...

Nga kjo perspektivë tani, plotësisht pa marr parasysh a është ajo gjuhë shqipe apo angleze. Mendoj, nuk e quajnë për koti ata në Kosovë, gjuhë e ardhmërisë, në njëfarë mënyre, por kjo përvojë e cila më ka mësuar që të mos i ndaj njerëzit, unë nuk i ndaj nga ajo periudhë e '99-tës. Dola nga banesa dhe shkova te ajo shitore pa e ditur asnjë fjalë shqip, se në atë kohë të pas luftësë, plotësisht ndërruan raportet, struktura e popullsisë në të gjitha banesat.

Më kujtohet, sikur t'ishte sot e kam atë fotografi në kokë me ato banesa të hapura gjërë e gjatë. Pra të gjitha banesat që nuk ishin shqiptare dhe njerëzit që ishin shpërngulur nga viset e ndryshme, fshatrave nga thellesitë, thjeshtë ishin vendosur në banesa të dikujt dhe flenin në shtretërit e dikuj, ushqeheshin me lugët dhe pjatat e dikuj të panjohur. Pastaj me të hyrë në atë dyqan, unë, unë prisja që të gjithë të dalin nga dyqani dhe më pas më drejtohet shitësi i cili është shqiptar dhe me thotë, "Samir, urdhëro, si mund të të ndihmoj?" Në gjuhën serbe. E unë i them atij, "Shiko, ne do të shpërngulemi, më duhen disa paketa, kutija për t'u paketuar, sa më të mëdhaja të kartonit për libra", sepse e kemi pasur një mal libra në banesë, dhe... Ai me tha, "Nuk ka problem, do t'i përgatis unë dhe t'i jap." Në atë moment e shoh se u mblodhën disa djem të rinjë para dyqanit.

Sepse, ata djem të cilët kanë jetuar me ne, djelmohat që kanë jetuar në të njejtën ndërtesë para bombardimeve më kanë njohur, unë kam ardhur, prej nga tash unë aty si... dhe në një moment u mblodhen nja 20. Viti '99 ishte viti i anarkisë së plotë në Kosovë. Dhe të gjithë ata që flisnin vetëm një fjalë të vetme serbe, pa marr parasysh cilën, pa marrë parasysh se kush është ai, si quhet, si e ka mbiemrin, gjuha serbe ishte pikë për të të vënë në shënjestër. A ishte për vrasje apo çka tjetër, por thjeshtë në '99-tën gjendja ishte e këtillë se kushdo që e flet gjuhën serbe do të binte në probleme serioze.

Dhe unë i thashë atij Halilit tim, kështu, "Dëgjom, unë nuk mund të shkoj në shtëpinë time", e shikojsha banesën time, terasën time aty afër 15 metra larg nga dyqani, por unë nuk mund të shkoja në shtëpi. Ai më tha, "Ku është problemi?" I thashë, "Tash këta do të më rrafjin apo ku ta di se çka mund të më ndodhë". Në atë moment njeriu doli. Unë shiqoja, shikoja se si ai e rrezikonte jetën e tij për të më mbrojtur mua dhe më përcjelli deri te dera e banesës sime bukvalisht deri, deri, deri te hymja e banesës sime, sepse ata djem mua më sulmuan. "Ti po flet serbisht, ti je i gjallë, ti që shkon në shkollë me serb, çka bën ti këtu?" Ata ishin të nxitur nga ata banorët e vjetër që ishin në atë lagje.

Por kjo përvojë mua më mësoi se kudo ka njerëz të cilët janë të pakëndshëm, por për mua ai Halili është plotësisht shembull pozitiv, i cili i zhvleftësoj të gjitha ato anët negative të cilat unë pata rast t'i shoh në atë periudhë. Siç ka edhe në anën tjetër shëmbuj pozitiv e negativ, por hajde do t'i numëroj vetëm pozitivet. Unë kam fat të takohem me njerëz pozitiv, njerëz magjiplotë dhe nuk kam pasur rastin të takoj pakënaqësi kudo ku kam qenë, them kushtimisht. Njerëzit e anës tonë janë të njohur, janë njerëz te cilët kurrë nuk kanë... dhe nuk di që dikush ka kidnapuar dhe ku, thjeshtë, ka të tillë që nuk janë kthyer kurrë, jo pak por me qindra i kanë kidnapuar. Bash nga ato vise prej nga vijmë ne, ky është koxha numër, njëqind njerëz të kidnapuar që kurrë më nuk janë kthyer, kurrë më nuk janë gjetur. Tash

se a kanë qenë ata të shfrytëzuar për diçka, për punë tjera unë për këtë jam plotësisht i painformuar, vetëm e di që ata njerëz kurrë më nuk janë kthyer pas atyre ngjarjeve. Një anekdotë shumë interesante është vet vëllau im i riu, i cili është i lindur në vitin '99.

Marijana Toma: Për këtë në të vertetë, desha të ju pyes, si kaloi kjo duke pasur parasysh se e ke përmendur se ai është i lindur në vitin '99, pas bombardimeve?

Samir Sezairi: Ai ka lindur, ai ka pasur 28 ditë para fillimit të bombardimeve. Nëna ka udhëtuar pasi që ishte me neve në Shkup, baba shkoi, babai shkoi në Beograd, në Prishtinë ku ne kishim patundshmëri, gjyshën e cila ishte nana e babës ishte në Kosovë, thjeshtë kur e ke një familje për të cilën duhesh... babai ka pasur shumë miq shqiptar të cilët janë shumë pozitiv, pozitiv dhe njerëz të mrekullshëm. E fliste atë gjuhë bukur. Thjeshtë situata në vitin '99 ishte specifike ku njeriu njeriut ia kishte grabitur banesën, ku i kanë shtyer që të shesin pronat për pak gjë. Për fat, gjatë gjithë këtyre ngjarjeve ne kemi pasur shumë miq të mirë të cilët na e kanë mbrojtur pasurinë. Pastaj babai e ka njohur shumë mirë gjuhën shqipe, prandaj edhe ai ka ardhur lirshëm shpesh herë... edhe nana vinte me të në Kosovë. E tani po më kujtohet tregimi i saj, e ky është kur e ka marr me veti vëllaun tim Damirin, kështu quhet vëllaun im, Damir, kur kane dalur nga shtëpia, ajo i ka thënë atij, "Damir, tani vëje dorën në gojë. Kështu derisa të hysh në automobil." E ky këtë e ka mbajtur në mend, dhe sa kanë dalur nga banesa ai e ka pyetur, "Mami, tash a duhet me e vnu dorën në gojë?"

Pastaj, kështu ishte situata por atij nuk i interesonte. Ai është i tillë, nuk ka pikë takuese. Ai dëshiron të shkojë në bjeshkë për skijim nëse është koha e mirë dëshiron të vizitoj gjyshën dhe gjyshin, por për te Kosova si Kosovë nuk ka kurfarë, bash kurfarë kujtimi. Ai është, bukvalisht prej lindjes ka qenë në Shkup apo në Beograd. Unë atij i them, "Ti je një beogradas klasik, ti nuk ke as edhe një pikë të përbashkët me Kosovën". Thashë, "Ne të cilët jemi më të vjetër e kemi" edhe unë kam dëshirë të shkoj atje. Te unë është, ndoshta qysh po rritëm unë sigurisht që po shkoj t'u pjekë, unë kam dëshirë të shkoj në Kosovë dhe mua tepër më terheq, të gjitha ato momente. Jo Prishtina, plotësisht nuk kam asnjë lloj ndjenje sentimentale ndaj atij qyteti, absolutisht. Nuk kam... madje edhe kur kaloj pranë ndërtesës sonë...

Marijana Toma: Edhe pranë faktit se ju atje jeni rritur?

Samir Sezairi: Ashtu është. Jo, nuk e kam ate lloj ndjenje, por sikur asnjëherë mos të kisha jetuar atje. Ndoshta pse ne kemi jetuar në Prishtinë edhe në Shkup, Beograd, pastaj kemi pasur disa herë idenë për t'u shpërngulur edhe në Australi. Për më tepër jemi mësuar me shpërngulje prej kur ishim fëmijë, mbase kjo është ajo shprehia e krijuar.

Por jo, Prishtinën si Prishtinë nuk e ndjejë, nuk, nuk kam emocione ndaj atij qyteti në përgjithësi. Kam ndjenja për Prizrenin. Prizreni është qytet specifik për mua. Por ndaj Prishtinës... tash vonë kam kaluar pranë ndërtesës time, hyra në ndërtesë, fola me disa fqinjë. Ju thashë, "Unë kam jetuar këtu

përtej rrugës”, por plotësisht, plotësisht e kam njejtë, mendoj, nuk e kam, nuk e kam atë ndjenjen për atë qytet.

Marijana Toma: A të, hmm... kujtohet kur ke shkuar në shkollë, tani do pyes për shkollë, do të thotë ti na fole pak për atë ndarjen, atë ndarjen e shkollës. Por, a ke pasur ndonjë shok, mik shqiptar në atë shkollë?

Samir Sezairi: Po, kur rrinim para ndërtesës kisha shokë. Po, kam pasur, kam pasur.

Marijana Toma: Sa të kujtohet, me çka keni luajtur, a të kujtohet diçka nga ajo periudhë?

Samir Sezairi: Po, po ishte diçka specifike për shembull, me ata. Ata ishin në një gjendje frige. Ata e kishin atë frigë. A ishte kjo e gjitha, kjo situata e cila ishte...

Marijana Toma: Ti tani po flet për vitet e ‘80-ta dhe atë...

Samir Sezairi: Flas për vitet ‘90-të.

Marijana Toma: Po dhe fillimi ishte në të ‘90-tat.

Samir Sezairi: Përpara e dini, përpara... tash... gjithmonë ishte një lloj ndasije, për shembull në çerdhe ne kemi qenë të ndarë. Thënë kushtimisht, ishim të ndarë. Ne kemi shkuar në çerdhe në të cilat nuk kanë shkuar shqiptarët. Kështu, shkolla fillore ku të gjithë edhe nuk shkojshin, nuk kishin, ndaj nuk kishim kontakte, kontakte direkte vetëm indirekte, komunikimi ishte në rrugë ose para ose pas shkollës, por atë komunikimin direkt e kishim përgjatë ndonjë shoqërimi, sidomos para ndërtesës. Por edhe ato ishin përvoja të ndryshme sepse... thjeshtë thënë gjithmonë ka qenë disi ‘ne’ dhe ‘ata’. Edhe pse disa herë kemi bërë përpjekje, hajde disi apo diçka, themi por ata gjithnjë kanë qenë një lloj korpusi në vete, gjë që na ka bërë të kemi këtë ndasi edhe ne të tjerët. Kjo është dhe ishte një lloj konstrukcioni. Nga fëmirija ishte ashtu. O, o, o {onomatope} këto ishin përjetimet e mija për atë periudhë, në atë periudhë.

Në atë nivelin më të lartë, në nivelin e prindërve tonë kjo ishte vërtetë krejt ndryshe, sepse njerëzit janë të pjekur, serioz, të cilët para të gjithash janë normal. Mendoj, i zgjedh njerëzit të cilët janë të nivelit tënd, jo të zgjedhesh do si do, por ashtu ... E kishim këtë shoqërorizim, mirëpo ishte ashtu disi periferik. Pra kryesisht ka qenë vetëm sipërfaqësisht. Ata e kanë pasur pjesën e tyre. Jo, nuk ishte sikur në Gazë të ndarë me mur e pastaj njëra pjesë të luaj në një anë, por thjeshtë nuk jemi përzier. Kryesisht nuk jemi përzier, edhe pse nuk ishte nevoja. Megjithatë, unë mendoj se mirë kemi funksionuar, por mendoj se të gjitha raportet vijnë nga familja, i bartim ato disi nga familja, sepse disi në familjen tonë, konkretisht në familjen tonë, tani po kthehem në vitet 2004, 2005, kur vëllau im i kishte pesë vjet apo gjashtë, e dini ...

Te ne kurrë nuk është folur se kush është serb, katolik, shqiptarë apo s'e di *šiptar*¹. Edhe pse ata e quajnë vetën *šiptar*, *šiptar*, po kështu e quajnë vetën, por nëse atyre u thotë dikush ashtu ata e marrin si emërtim ofendues. Ne kurrë nuk e kemi përdorur atë terminologji e as në ditën e sotme, se a janë ata *ustaš*, *četnik* apo *šiptar* apo diç tjetër. Sepse vëllaut tim kur ishte i vogël, derisa luante para banesës i ka ndodhur të përballët, atij i kanë thënë disa fëmijë të vegjël pesë-gjashtë vjeçar, “Po ti koke kokë *šiptar*”, diçka të ngjajshme. Jo direkt atij po si në bisedë e sipër. E çka ishte edhe më interesante, ai vjen në shtëpi dhe pyet nënën time, kështu, “Mami çka është kjo fjala *šiptar*?” Tash si t’ia spjegosh fëmiut pesë vjeçar, çka është kjo?!

Kështu që, te ne nuk ka pasur gjëra të këtilla, jo, thjeshtë ne nuk i kemi pasur këto, për neve kjo ka qenë plotësisht normale. Prandaj po them se këto gjëra njerëzit i sjellin prej shtëpive të tyre, mendoj këtë pasqyrë ua japin fëmijëve, pastaj ata e bartin atë në rrugë, para ndëtese, pastaj i zgjedhin njerëzit në bazë të kësaj... Por definicioni se për shqipëtarët kanë qenë, unë përdori emërtimin shqipëtarët sepse mendoj që për mua është plotësisht normal që ata kanë qenë ndryshe, kinse janë të këtillë; se nuk punojnë asgjë, ata janë të papastër, ata janë ndryshe e tjera. Kështu ishte definicioni, thjeshtë, lidhur me ta, mbi këtë bazë njerëzit, fëmijët pa asnjë bazë e kanë krijuar këtë urrejtje të pabazuar ndaj dikujt apo ndaj një fëmiu shumë normal me të cilin do të duhej të shoqëroheshin.

Marijana Toma: Më thuaj tani në cilën anë qëndron, e përmende në një rast se në princip ti personalisht je më shumë i lidhur me, me, Prizrenin se sa me Prishtinën, edhe pse aty je i lindur dhe aty je rritur e tjera. Në Prizren ti po e supozoj, do të kesh shkuar vetëm në pushime te gjyshja e gjyshi dhe kështu përafërsisht, mendoj, çka të kujtohet nga ai Prizren?

Samir Sezairi: Prizreni... unë e dua historinë e atë e gjej në Prizren... Ai është i vetmi qytet në Kosovë, hajde nuk po i llogarisë manastiret dhe ato që i ka bota, thjeshtë, por Prizreni është qytet specifik, ai qytet ka shpirt. Në Prizren kemi, kemi edhe, edhe, edhe, serb, musliman edhe turq e shqiptar dhe të gjithë flasin. Do të thotë, të gjithë i flasin të gjitha gjuhët. Pra këto e bëjnë specifike këtë qytet, sepse ata i flasin gjuhët e njëri tjetrit dhe kjo për mua është fascinante. I vetmi qytet që e ka lumin. Mendoj, lumin e vërtetë, Bistricën e cila është lum i vërtetë.

Qyteti që ka kalldërm, i cili ka një lloj tradite, ka edhe xhamija e kisha... Unë kam shkuar atje, unë e kam gjyshen atje, nëna e babës, ajo jetonte në qytetin e Prizrenit. E meqenëse ajo ishte fëmijë i prindërve të ndarë, babai i vet ka jetuar në një fshat sipër Prizrenit, pastaj ne kemi shkuar shpesh te ajo. Për Bajram, për kohë të pushimeve shkollore dhe kështu isha shumë kohë atje në atë qytet. Pastaj pushimet verore i kalojsha atje, veçanërisht vikendet, sepse e kemi vizituar gjyshen dhe e kam dashur shumë verën në Prizren sepse ne vazhdimisht lahemshim në Bistricë. Edhe tani kur mendohem nga kjo

¹ Emërtim derogativ për shqiptarët e Kosovës, dhe mënyre e krijimit të një etniteti ndryshe nga shqiptarët e Shqipërisë.

perspektivë, sa herë që shkoj në Prizren them me vete, “Au shikoje këtë lum të vocërr, tashmë qenka shnëdrro në një lloj potoku”.

Më kujtohet njëfarë fëmijërie disi me atë vizionin prej fëmije, ai ishte për mua njëfarë lumi sepse ne në atë lum laheshim. Në të vërtetë ai është një lum i vocërr, por... meqë prejardhja ime është plotësisht nga Prizreni, unë pata rastin t’i shoh dallimet në njerëz, njerëz në tesha kombëtare, njerëz që bëjnë shitje në treg që vinin nga mjedise të ndryshme, nga qytete të ndryshme prej të cilave kishin ardhur. Ajo kulturë në tërësi e Prizrenit është ruajtur edhe deri në ditët e sotme në njëfarë mënyre. Ai qytet i ka thyer barrierat gjuhësore pra ky është Prizreni. Sepse është qytet në të cilin kanë jetuar shumë... nuk e di, por goran dhe musliman po, sado që ata deklarohen si boshnjak.

Megjithatë, kjo e tëra është pjesë e një, një lloj folklori i cili zgjon interesimin sipas situatës politike sepse tani është i popullarizuar në Kosovë, deklarimi si boshnjak sepse e konsiderojnë si një lloj... si mënyrë ku mund të notojnë politikisht, edhe pse ne nuk kemi kurrfarë lidhje me, me, me Bosnjën, përveç që ndajmë hajde të themi, momente të besimit, por në të vërtetë nuk kemi asnjë lidhje as me gjuhën e tyre, as me kulturën që e ka Bosnja, por ja që njerëzit deklarohen si boshnjak sepse i tillë është momenti politik në të cilin iu del njëfarë përfitimi edhe për vetën edhe për atë lloj bashkësi. Plotësisht legjitime. Kjo është plotësisht legjitime. Sikur që goranët e kanë krijuar një brend, unë i quaj brend për vetvetën. Ky është një regjion malor i cili quhet Gora, por ata janë qytetarë lojal të një shteti, respektojnë kushtetutën dhe ligjin, si të tillë ata janë të pranuar si goran e kjo është plotësisht legjitime.

Por e gjithë kjo, ajo gjuhë interesante për shembull, ajo përzierje, variantat e kësaj gjuhe, për mua është e panjohur, ne në shtëpi flasim kështu. Thjeshtë nuk kemi, nuk kemi një dialekt, shkon në fshat i dëgjon njerëzit flasin një gjuhë tjetër e pastaj ti po... pak a shumë kjo është e pakëndëshme nga perspektiva, tani duhet mësuar atë gjuhë, thënë kushtimisht, por, nga perspektiva e një fëmiju kjo ka qenë, tani ai të flet në një lloj gjuhe, e ti ke ardhur nga një qytet, themi tani ke ardhur nga Prishtina dhe ti je i rëndësishëm dhe i thua atij, “Po mirë, por unë ty aspak nuk të kuptoj.” E në të vërtetë ti e kupton, por ai flet krejtësisht ndryshe.

Kështu që, këto janë disa kujtime lidhur me Prizrenin dhe Prizreni për mua është një qytet jashtzakonisht i dashur. Për mua është kështu, sepse, sepse kam një mori shokësh të cilët edhe tani i vizitoj. Dhe unë jam i tillë, një njeri i cili dhe këto t’i kam thënë edhe ty në atë bisedë telefonike, unë kam dëshirë t’i vizitoj disa nga ato monumentet e kulturës. Pa marrë parasysh a janë ato xhamija, kisha apo objekte të tjera fetare, për mua është një respekt ndaj, ndaj, ndaj traditave dhe ndaj kulturës si dhe ndaj një populli cilido që të jetë ai. Këto janë shtëpi të Zotit, besuam apo nuk besuam në Zot apo në cilin Zot besojmë, por thjeshtë unë këtë e ndiej shumë, shumë sinqerisht dhe me shumë emocion sepse...

Në një moment e morra edhe nënën time, për herë të parë. Mendoj, njerëzit kanë frikë nga e panjohura. Do të thotë, ky është problemi më i madh këtu sepse kanë frikë nga e panjohura dhe kjo është ajo që unë e dua, unë dëshiroj kur t'i thej ato bariera, dhe, dhe njerëzimi duhet të njoftohen, duke u njohur me kulturën, kombin, gjuhën, ti vertetë i njofton në thelb këta njerëz dhe e zgjeron diapazonin, ndaj unë dëshiroj të shoqërohëm më priftërinjë. Mendoj, ti mua tani, tani kur e them këtë me duket sikur thua Samir, a e din, unë e kam një mik shumë të mirë në manastir afër Prizrenit, Shën Arhangjelli, e dini aty është afër ...

Marijana Toma: Po, po, po, e di.

Samir Sezairi: Ky vend është saktësisht sipër, aty sipër Prizrenit, thjeshtë vetëm sa jemi njoftuar. Unë shkoj në festat e tij. Kryesisht, do të thotë shkoj special për festën e tij në manastir, te Mihajlo, sepse unë atë e respektoj, e vlerësoj atë së pari që është Mihajlo, pastaj nuk e di, por ai është ortodoks, pastaj është serb, pastaj është prift. Dhe, dhe, dhe, këtu pak thehet ai, ai, ai, tregimi negativ lidhur me personat fetar, e që kur e njofton ndonjërin nga ata, pra ndonjë person fetar i cili vërtetë beson në këtë, atëherë ty tërësisht të, në anën tjetër ti shikon në TV diçka tjetër, njerëz tjerë, persona fetar, dhe në bazë të kësaj pastaj ti e krijon mendimin, prandaj duhet t'i njoftosh këta njerëz. Por unë po e përmendi shumë këtë Mihajlon, e përmendi sepse është shembull pozitiv, themi edhe pse është person kishtar.

Familjarët e mi, sidomos nëna ime për shembull e ka pasur një lloj frige, “Çka kemi na me hy në manastir?” I thashë, “Hajde në manastir, po du me të njoftu me, me njeriun”. Edhe vajzën e xhaxhait, e cila është e lindur në të njëjtin fshat prej nga edhe ne e kemi origjinën. Fshati është tri kilometra larg, prej këtij fshati ku jeton axha ...

Marijana Toma: Ajo asnjëherë nuk ka qenë në atë manastir?

Samir Sezairi: Asnjëherë nuk ka qenë edhe pse çdo ditë kalon aty pari, para atij manastiri gjersa shkon në shkollë, asnjëherë nuk ka qenë. Unë e çova për herë të parë edhe ajo më tha, “Po çka kemi ne në manastir?” I thashë, “Po shkojmë me të njoftu”, i thashë, “do të njoftoj me një njeri”. Pastaj ne kemi qendru në darkë afër dy orë që të kuptojë... dhe fjalja e saj e parë me t'u futur në automobil për t'u kthyer, “Ej po ky Mihajlo qenka super”. “Po”, i thashë, “po, pra Mihajlo është njeri para të gjithash, kështu që ...” e kjo ishte përvoja e nënës time e cila asnjëherë nuk, nuk e ka me atë, atë...

Ajo e din që domosdo, meqenëse e kemi rrugës, duhet të shkojmë në magjistrale kur të del nga Prizreni dhe duhesh të kalosh pranë manastirit, për t'u ngjitur në fshat. Unë them, “Duhet të kthehemi te Mihajlo madje për pesë minuta, t'i lajmërohemi Mihajlos”, pastaj thashë, “vazhdojmë tutje”. Me, me, me Stefanin kemi qenë, ai, me atë shokun tim, ishim katër veta, më kujtohet në festën e 1 majit. Na u lidhën festa e majit me festën e Pashkëve, pastaj na u lidhën ditët e 1 majit me Shën Gjergjin edhe atëherë ne i kemi vizituar ata në kishë dhe shkuam lartë në Gorë, atje ata e kanë festën tradicionale të Shën Gjergjit.

Pastaj, për 1 maj kemi shetitur dhe në një moment Mihajlo na tha, “Çka do të donit të vizitoni?” Unë i thashë, “Së pari da bëjmë gjumin atje te unë në, në, në bjeshkët e larta”. Thashë, “Zgjohemi në mëngjes do të vijmë në liturgji”. Unë jam zgjuar i pari natyrisht, ata ishin në gjumë. Thashë, “O njerëz, prit, por ju do të vonoheni, mendoj liturgjia është e juaja, se unë nuk jam i detyruar, nuk duhet as të vijë me ju, s’ka problem, por ju do vonoheni për në ritualin tuaj, në liturgji”.

Pastaj, mbërrijtem në atë liturgji, me neve ishte edhe një mik i gjyshit tim, ai ka qenë me të në shërbim ushtarak, i cili në ndërkohë u konvertua në katolik. Me 83 vitet e tij me shumë respekt për të, pastaj, në atë moment ata hyne në liturgji, Mihajlo e udhëhoqte atë ditë dhe ai i tha atij Savës tim, shokut, “Ku është Samiri?” “Po qe e lamë Samirin te porta e manastirit”. “Po pse nuk po hynë?” Nuk e dija se si të ia spjegoj tash, a nuk po e din se unë jam Samiri? Ai duke thënë, “Thirreni se tash fillon liturgjia...” në atë çast e ndërpresin Mihajlon, i cili ka pamje të Obeliksit. Do të thotë, definicioni i Mihajlos me atë hunden si babure, dy metra i gjatë, me ato duar të mëdha, do të thotë një Obeliks i vërtetë. Shkurtë definicioni për të është Obeliks. Edhe i thotë, “O njeri, na nuk mund ta thërrasim djalin me zor, e din ti që ai është Samir, si të asistoj ai në liturgji.” Au unë paskam harruar fare, sikur ai është ...

Duke vizituar këtë, këto manastire, e përmenda manastirin e Deçanit të Epërm, i cili për mu është ndër më të bukurit, më të bukurat manastire që kam pasur rastin t’i shoh e unë i kam vizituar një numër të madh nëpër Serbi. Pastaj, duke u kthyer, Mihajlo na thirri, “Njerëz kthehuni, më duhet vetura”, sepse ne me veturën e tij që e ka me tabela “KS” kishim shkuar për të mos pasur probleme.

U kthyem dhe mbetëm ne të katërtit në manastir. Në një moment u dëgju zilja e telefonit fiks dhe ai më tha, “Unë, më duhet të shkoj deri në Prizren për t’i bërë disa furnizime por juve do ju lë këtu”, “Jo, nuk ka problem” i thashë. Mendoj, unë aty ndihëm si në shtëpinë time, ashtu edhe sillem si në shtëpinë time, absolutisht. Pastaj ai shkoi dhe prapë telefoni, unë u lajmërova dhe thashë, “Këtu manastiri i Shën Arhangjelit, urdhëroni, Samiri në telefon”. Nga ana tjetër u shokua dikush për pesë sekonda. Pastaj u lajmërua një grua, i thashë, “Urdhëroni, zonjë!” Kinse, “A është ky i manastirit?” I thashë, “Po, manastiri është, Samiri pranë telefonit, urdhëroni, a mund të ju ndihmoj?” “Mua më duhet Mihajlo.” Thashë, “Mihajlo është në Prizren, kthehet për disa orë, a keni ndonjë porosi?” “Duhet të vi nga Krushevcit”. Thashë, “Ju lajmërohet Mihajlo, nuk ka problem”.

Në ndërkohë lajmërohet një shok i imi i cili poashtu është nga Kosova, nga Mitrovica e Kosovës, Aleksandari dhe me pyet, “Ku jeni?” Thashë, “Qe ku jemi, ne jemi në manastir”. Thotë, “Po, çka po bëni?” “Qe po rrijmë, na ka lënë Mihajlo vetëm”. Ai thotë, “O njeri kujdes se po e kallni atë manastir i cili është i vjetër me shekuj, kush ua la juve të kujdeseni për manastirin?” E kështu unë kam disa kujtime, disa kujtime të mrekullueshme, shumë të mrekullueshme që më lidhin në mënyrë të përgjithshme me Prizrenin.

Marijana Toma: E më thuaj, këtë e ke përmendur disa herë, me thuaj për këtë prirje, po e shoh se vertetë ju e doni historinë, traditat, e tjera. Kur e ke vërejtur këtë prirje në vetën tënde? Përgjatë studimeve apo, apo si fëmijë?

Samir Sezairi: Për mua kjo histori ka qenë një gjë që më ka interesuar gjithmonë. Dhe kryesisht edhe si lëndë shkollore dhe e kam dashur shumë edhe kur jam regjistruar në fakultet thjeshtë nuk kam pasur tjetër, nuk kisha *back-up* plan në raport me shkencat politike të cilat janë shkenca shoqërore ku mësohet, hajde historija nëpërmes të ndonjë forme. Por, pasi që mbërriva në vitet e pjekurisë, aty kah vitet e 20-ta, të themi nuk kam shkuar më në fshat.

Raportet specifike të prindërve, them të babait tim, thjeshtë, edhe në anën tjetër, në kemi shkuar në Prizren, por nuk kemi shkuar në fshat. Tek pas viteve të mija të 20-ta, të themi nuk e kam praktikuar shkuarjen në fshat. Prandaj neve njerëzit nuk na njohin, por na njohin si fëmijët e dikujt, na pyesin, “I kujt je ti, kënd e ki gjysh, cilin e ke baba?” Madje as babain tim nuk e njohin, sepse ai me 18 vjetët e veta ka dalur prej atij fshati, por na lidhin njohësitë përmes gjyshit, xhaxhallarëve, e tjera.

E tani fillova, e tani, shpesh shkoj së paku një herë në vit shkoj, prej që jam 20 vjeç shkoj minimum një herë në vit. Pastaj, mua më intereson ajo, hajde ta shoh ku jemi ne, prej nga ky mbiemëri i jonë Sezairi, se si ishte Sezaireviq, më parë. Kush është bash ai paraardhësi i jonë?! Pastaj kthehem në mënyrë kronologjike kësaj historie dhe pastaj vie deri në situatën që e dijmë, që nuk dijmë shumë rreth, kur i marrim parasysh ato vite e dijmë deri te paraardhësi i viteve 1870. Kjo ka ardhur para atij. Nuk është me rëndësi nëse është ai, a ka qenë ai ortodoks, katolik apo ndonjë musliman i cili ka ardhur, thjeshtë, ne nuk kemi informata absolute, bash kurrëfare sepse njerëzit nuk u kanë kushtuar vëmendje këtyre gjërave.

Sepse ka, migrime të popullsisë deri në atë masë, si për shembull ata të besimit ortodoks migrojnë menjherë posa e mbarojnë shkollën, pastaj shkojnë në qytete më të mëdha, dhe janë të shkolluar kryesisht, por ka për shembull, ka musliman të rrethit tonë, ata kryesisht kanë qenë punëtor, ajo anë është shumë e njohur me njerëz të klasës punëtore, ndërtimtarë, armirues ku ta di unë, moler, punëtorë të qeramikës dhe kështu...

Natyrisht, gjithmonë kanë qenë te varfër. Kanë qenë shumë të varfër. Një numër i madh i fëmijëve... Këtu edhe ndërron struktura demografike, sepse disa shkojnë e në ndërkohë disa mbesin dhe kanë pasur shumë fëmijë, prandaj kjo përqindje e popullsisë ka ndryshuar deri diku kah viti '95. ishte 80-20 në favor të muslimanëve. Gjuha dhe tradita është një lloj baze e tyre dhe...

Por ky jam unë, kur shkoj në fshat, kur shkoj në fshat i vizitoj varret. Nëna ime thotë “Ti, bre, nuk je normal, për ty do mendojnë njerëzit se je i marrë.” Por mua më intereson kjo, është në rregull kur ti i ke varrezat, ku ta di unë, të gjyshit, stërgjyshërve, katragjyshërve dhe ashtu është. Këtu shihet shumëllojshmëria e mbiemrave. Se si njerëzit i kanë ndërruar, nuk e di, gjyshi dhe stërgjyshi ishin

Sezairoviq dhe për shembull, gjyshi im ishte Sezairi. Në anën tjetër xhaxhai i cili ishte i vogël kur vdiq, njëri nga axhallarët, ai për shembull ka mbiemrin Senadoviq. Kjo është plotësisht një lloj pahitëse, mendoj pahitëse e mbiemërave, si fryejnë dhe si i ndërrojnë mbiemrat nga më të ndryshmet dhe për arsytet më të ndryshme, ndaj janë ndërruar sa herë, por hajde ta gjejmë atë lloj rrënje. Tani jo vetëm me qëllim për ta kuptuar kush jemi tani, thjeshtë, hajde ta kuptojmë nga e paskemi prejardhjen, çka dhe si? Dhe unë e hasa diku atë kronologji atje në, në, në Deçanin e Epërm. Rastësisht, një regjistrim i popullsisë nga viti 1571 të cilën e kanë bërë Turqit.

Pra, kjo nuk është e tanishme, këtë e kemi punuar unë e ti, dhe ne tani i kemi dhënë formën e dëshiruar sipas nevojës dhe në pajtim me erërat e situatës politike, por ky është përshkrimi nga regjistrimi i popullsisë i përkthyer në gjuhën serbe. Instituti Historisë në Serbi, i cili i bëri aty rreth 300 kopje të librit “Regjistrimi i popullsisë në tërë sanxhakun e Prizrenit”, përkatësisht Çarku i Prizrenit. Sandxhak do të thotë nga turqishtja, çark.

E unë i gjeta, i gjeta, i gjeta aty ishin, ekziston regjistrimi i vitit 1571 për atë çark prej nga janë njerëzit e mi, të Zhupës së mesme dhe aty ishte fshati ku ka lindur gjyshi im. Ishin të shënuara me ngjyrë, të kuqen e kishte për ortodoks, të gjelbërt për musliman, logjikisht - e gjelberta, do të thotë ne jemi të gjelbërt dhe ngjyra vjollce për katolik. Ai fshat dhe e gjithë ajo rrethinë në vitin 1571 ishte në të kuqe kur edhe është bërë regjistrimi, përkatësisht atje kanë jetuar ortodoksët, por ka sqarim interesant, shumë preciz, sqarime kush sa ka borxh për tatime, kush sa ka pasur drithëra, sa të veja kanë qenë, sa kanë qenë të pamartuar, kështu që kishte një mori sqarimesh por jo edhe për mbiemrat.

Mirëpo, ishte Mihajlo Jovanov, nga babai Jovani, pas një kohe ishte kthyer në mbiemrin Jovanoviq besoj që edhe sot, sikur Mihajlo dhe Jovani, dhe vëllau i tij, nuk e di, Dushani dhe djemtë e vet Mehmedi dhe Osmani. Në këtë pjesë ekziston sqarimi se fëmijët e tij e kanë përqaftuar islamin. E tani, a kanë qenë të shantazhuar nga njëra anë, dhe në anën tjetër ndoshta kanë pasur beneficione, sepse nuk kanë paguar tatimin, kanë pasur jetë të lehtë, jetonin në qytet, tani këto janë disa situata të ndryshme, pastaj, pse njerëzit i kanë pranuar, i kanë pranuar dhe e kanë ndërruar edhe fenë. Në ndërkohë, migrimi, numri i madh, pastaj, zgjerimi i familjes ka bërë që ata njerëz të vijnë te kjo situatë...

Kjo është si në atë filmin, gjegjësisht në atë librin “Thika”, kur, kur, kur ai hoxha që e kishte prejardhjen ortodokse e thotë kinse, “Ata që e pranuan islamin u kthyen kah Stanbolli”. Ai për prindët e tij e ka ndërtuar kishën në atë vend, ndërsa për vehte dhe pasardhësit e tij ndërtoi xhami, do të thotë ai vetëm e ka vazhduar, ka vazhduar prapë në atë familje, por për prindërit e tij të krishterë ndërtoi atë, ndërsa për vete dhe fëmijët e vet kinse tash po beson në këtë, për vetën dhe fëmijët ndërtoi një xhami.

Mirë, kjo më tërheqë, tash e kam një ide. Tani e mora një gjenealogji të cilën e kam blerë, tani e kam të renë dhe e kam idenë që kur të shkoj herën tjetër të gjejë ndonjë njeri më të vjetër dhe deri ku mundem. Pra, tani sikur, a është gjyshi im, stërgjyshi im, nuk e di, deri ku taksativisht [mund ta

gjurmohet], por do shohim emrin, mbiemrin, me çfarë është marrë, çfarë ka punuar, sa ishte i gjatë, pesha, kush ishte gruaja e tij. Pastaj kronologjikisht vijmë deri tek unë dhe pastaj e bartim në gjeneratën e ardhshme sepse duhet filluar diku. Thjeshtë nëse ata nuk i kanë kushtuar vëmendje, e besoj që ekzistojnë nëpër libra kishtare, derisa të gjinden dhe të hapen, sigurisht që ka, për prejardhjen e mbarë atij regjioni janë bërë regjistrimet nëpër libra kishtare. Mendoj që këto kishtaret ekzistojnë prej kur ekzistojnë edhe fshatrat, shumë e logjikshme. Mirëpo për këtë do të shoh këtë vit, kjo është njëra nga detyrat e këtij viti kur të shkoj atje në fund të gushtit, të shoh dhe të bisedoj me dikë dhe me themel do të iu hy gjërave, do të përkushtohem. Por varësisht ku do të arrijë, do të shohim.

Marijana Toma: Më thuaj, tani do të kthej prapë në Prishtinë, dhe atje në atë, hmm, hajde në periudhën e paraluftës. A të kujtohet diçka, pastaj, kur për ty filloi lufta, ti ishe i vogël, ti i kishe dymbëdhjetë, trembëdhjetë vjet, ti jetoje në Prishtinë, hajde të themi, mosha yte të bënë të jesh i mbrojtur, por a ke diçka që mund të kujtosh, pastaj, si filluan ato lajmet, a kishte një lloj lajmi, cilat ishin lajmet e para, si, si i përjetove ti, cilat janë kujtimet e para që diçka nuk është në rregull dhe do të fillojë lufta?

Samir Sezairi: Për shembull, ti ishe në Kosovë, ti i din atje, ato, pjatat satelitore, tani ato janë moderne si kablla televizive të '90-tave, si gjithandej nëpër Serbi, ne i kemi pasur tri kanale. Në Beograd ndoshta hajde, atje kishte më shumë kanale, por ne jemi në Prishtinë dhe e kishim RTS 1, 2 dhe 3 dhe, dhe, dhe TV Prishtinën. Eh kjo ishte pamja jonë në botë, asgjë tjetër. Do të thotë vetëm ajo që na servohej nëpër ato kanale dhe ne atyre u besonim. Thënë kushtimisht, u besonim. Derisa nuk u paraqitën televizionet me satelitë, përkatësisht pjatat satelitore.

Dhe ti tani i ke prindërit të cilët janë normal, i kanë miqët e vet edhe nga njëra anë edhe nga ana tjetër, të cilët nuk janë të ngarkuar me këto gjëra, thjeshtë.... Më kujtohet, do të thotë, bash si sot, kjo ishte një ditë vere, dreka shtrohej në orën 4:00 domosdo, sepse nëna punon deri në orë 3 e gjysëm, baba vinte në katër, dihej se tani ishte koha e drekës, lajmet në orën 4:00. Lajmet në orën 4:00 në RTS si lajme të para dhe bazike.

Parashikimi i motit, 32 shkallë, është ngrohët, në mënyrë sporadike ndodhin disa të shtëna, disa të shtëna në afërsi të Prishtinës, kjo po ndodhë nja dhjetë kilometra afër teje, kjo ishte si prej këtu në Zemun për afërsisht, kaq ishte numri i kilometrave, por asgjë e veçantë, kjo ishte. Pastaj e lëshuam *Deutsche Welle*. Dihet kjo ishte një lloj burimi i informatave, nuk e di, ka pasur më shumë, atje më duket Zëri i Amerikës, njësoj në gjuhën serbe, pastaj disa lajme në *Deutsche Welle*, dhe ti dëgjon se atje dikund kanë arritur tanket, atje po shtiejnë seriozisht. Ne ishim duke ngrënë drekë, koha e mirë dhe po mendojmë ku mund të shkojmë ne deti, mendoj kjo më është fiksuar në kokë.

Marijana Toma: Kjo më falni, kjo është '98-ta, a është kështu?

Samir Sezairi: Kjo është '98-ta. Thjeshtë, njerëzit dikund ishin mashtruar si në ëndërra, poqëse kanë besuar në këtë, në njërin nga këto, pastaj nga ana tjetër ti i ke të gjitha në TV *Deutsche Welle* me ton dhe fotografi, ishte, Zëri i Amerikës, mendoj se ishte kjo në mbrëmje aty ka ora njëmbëdhjetë e gjysëm e di që ishin disa lajme, në atë kohë babai im i ka përcjell domosdo. I lëshojmë lajmet në shtatë e gjysëm në RTS ku i dëgjojmë tregimet e bukura dhe pastaj në njëmbëdhjetë e gjysëm dhe aty ai e përjeton ate sikur, “Nдалu, bre, çka po ndodhë a? Kjo nuk është situatë normale”. Por duke i shikuar këto lajme në orën katër pasdite, ti hanë drekën dhe planifikon pushimet verore, sikur nuk po ndodh asgjë.

Por kështu është, kjo është një lloj përvojë sikur edhe për, për, dhe për fillimin e bombardimeve, njësoj. Sikur ata po diskutojnë, ata prindërit e mi në mes veti diskutonin, thotë babai sikur, “Jo, po prej asaj nuk ka asgjë, jo mo se ata sikur po kërcenohen pak tani nuk do ketë asgjë”, dhe ajo thotë, “Aman, bre, njeri e lajmëruan tash një gjë, nuk kam ide, në *Deutsche Welle*, sikur avionet do nisen sonte.” “Jo nuk ka asgjë prej kësaj.” Pra kështu na e pritëm bombardimin, mua më ndodhi kështu.

Marijana Toma: Ju keni qenë në Prishtinë?

Samir Sezairi: Unë bombardimet i prita në mbrëmje. Unë jam i vogël, në klasën e pestë isha jashtë, duke lozur. Më kujtohet, atë ditë ne nuk shkuam në shkollë, pastaj, unë kinse ashtu, “Nënë, më jep bukë jam i uritur, të ha diçka”, unë u ula për të ngrënë, kur në orën shtatë e gjysëm, rryma u ndal përnjëherë dhe një bombë bëri zhurmë dhe e tundi gjithë ndërtesën. Dhe kjo ishte, në atë moment, në atë çast ti në të vërtetë e kupton, pra e kupton se diçka filloi.

Marijana Toma: E kështu tek fqinjët, a ke vërejtur diçka, pastaj, pasi Ulpiana është afër në te cilën ka, aty kane jetuar shumë shqiptarë, serb dhe musliman?

Samir Sezairi: Nuk na ndodhi asgjë konkrete përderisa nuk filloi. Do të thotë ajo ditë ishte si një reaktion inicial në, në, në gjëra të pabesueshme te cilat po ndodhin pasi që ne kemi qenë aty në javën e parë te bombardimeve. Javën e parë mbase edhe dhjetë ditë të bombardimeve, dhe deri në çastin e bombardimeve, derisa nuk filloi, nuk, nuk ndodhi gjë, asgjë spektakulare nuk ndodhi.

Natën e bombardimeve ishte situata e ngarkuar rreth furnizimit, çka po ndodh, hajde ta blejmë këtë, masovikisht blejshim ujë, vaj, sheqer dhe miell e kështu disa gjëra, por kur krisi bomba e parë, pas bombës atëherë u ndërrua gjithçka, u humbëm krejt, u premë, u shkëput vegëza e cila të sjell në situata të pabesueshme, thjeshtë. Ditën nuk ndodhi asnjëgjë. Kushtimisht mund të them nuk ndodhi asnjëgjë.

Ne ishim fëmijë, bombradimi filloi në mbrëmje, pastaj ata kanë bombarduar ditë e natë, por në fillim ne kemi dalë jashtë, normalisht fëmijët shqiptarë kanë qene te mbyllur në shtëpi, nuk kanë dalur fare. Meshkujt nuk kanë dalur fare, pa marrë parasysh se kush e tek janë, do të thotë s'ka lidhje a është Serb

apo shqipëtar, thjeshtë nëse je shqiptarë të deportojnë, nëse je serb atëherë të marrin si ushtarë rezervë në përbërje të ushtrisë thjeshtë, vetëm nënat kanë dalur më kujtohet, nëna ime ka shkuar gjithmonë për të na furnizuar, por për një çast edhe kjo ndërroi dhe kemi, nuk të kujtohet...

Mua nuk më kujtohet asnjëgjë, thjeshtë nuk e kam marrë atë ndjenjë nga perspektiva e një fëmije, por daja im ka jetuar në ndërtesën pas neve, ai është mjek dhe na tha “Shikoni, unë nuk dua të qëndroj këtu do të shkoj në Maqedoni”. Dhe sikur thotë, “Hajde merrini disa gjëra”. Më thotë mua nëna, “Po shkoj te vëllau dhe t’i marrë disa gjëra”. Më është dashur ta marrë një kamerë nga ai.

Dhe unë shoh para ndërtesës sonë po vijnë disa xhupa, të hapur, thjeshtë njerëz me maska, me maska dhe uniforma, me kapela dhe po futen në ndërtesa. Na dëgjuan ata që neve flisnim serbisht, nuk kemi asnjë lloj problemi, mendoj ishim fëmijë, ku dijnë fëmijët në të vertetë cka po ndodh. Ne e morëm atë kamerë dhe u kthyem në shtëpi. Pastaj ata, “Çka po ndodh?” Thashë, “Jo nuk e kam idenë, disa njerëz u futën nëpër ndërtesa”, nuk më kujtohet nëse atëherë kanë filluar t’i nxirrnin njerëzit nga banesat. Këtë nuk e di, por më kujtohet ai lum i njerëzve të cilët kalonin rrugës, në atë rrugë tash është bulevardi, atëkohë ishte në dy traka që vinin nga Bregu i Diellit prej së larti, sigurisht janë ata njerëz të cilët kishin marrë batanijet me vete, fëmijët dhe disa gjëra elementare, ata i drejtonin kah treni i cili i dërgonte... nuk e di ku, deri në kufi të Maqedonisë apo deri në kufi të Shqipërisë. E pra këto janë, këto gjëra më kujtohen si sot, plotësisht si dita e sotme.

Por meqenëse akoma nuk patën filluar bombardimet, babi im ishte plotësisht i bindur se nuk do ndodh diçka ishte i bindur jo, jo, nuk ka gjë prej kësaj. Mendoj edhe pasi që mbaruan bombardimet, ai është utopist i cili ka besuar deri diku, meqë ne e kishim firmën e cila merrej me veprimtarinë e qelqit, av av av “Super, tani do mbarojnë bombardimet, tani do të fillojë puna sa të duash, do të ketë punë”. Sepse dikush e ka kuptuar në formë naive, sigurisht ne që e përjetuam, të gjithë që e përjetuam ndonjë, një luftë, direkt apo indirekt, ata e dijnë se kthim në të vjetrën nuk ka më. Do të thotë kthim në të vjetrën nuk ka, e as përafërsisht asaj nuk ka, por sigurisht ata që nuk e kanë përjetuar asnjëherë, ata dhe tani e tutje kanë momente utopike. Por nuk ka lidhje të gjitha mbaruan, do kthehemi të gjithë, ne do kthehemi në shtëpitë tona, që nga e hëna do të fillojmë punën, por nga puna nuk kishte asgjë, e gjithë ajo...

Pjesa e Dytë

Marijana Toma: Ti me the se ishit shtatë ditë, për aq sa unë kuptova, në periudhën e bombardimeve në Prishtinë. Si keni vendosur të shkoni? Mendoj, çka u bë? Duke pasur parasysh se babai yt ishte i mendimit se nga kjo nuk do këte asgjë.

Samir Sezairi: Ne kemi, ne kemi vendosur ashtu që thjeshtë ishte ideja që... dita e bombardimeve... Bombardimi, thjeshtë kur nuk beson në të dhe ajo të konfronton në mënyrë klasike. Neve na zurën

bombardimet, kemi mundur të ikim shumë më herët, por, “A do ikim apo jo?” E kishim gjyshin dhe gjyshën të cilët jetojnë në Shkup, kemi mundur të mos e përjetojmë atë moment fare. Fillojnë bombardimet, por ne e morëm vendimin sikur po ikim, ok ikim për, për, për Shkup. Nuk e di nëse ishte dita e dytë apo e tretë e bombardimeve dhe ne arritëm në kufi. Aty na kanë kthyer nga kufiri.

Marijana Toma: Kush? Policia?

Samir Sezairi: Policia, po. Aty na kanë kthyer. Në rrugë nuk kishte njeri. Nëna ime me fëmiun që i ka tridhjetë ditë, ne dy të vegjëlit mbrapa, baba i cili bukvalisht erdhi të na dërgojë në kufi edhe ai u kthye për në Prishtinë. Në ndërkohë në Grykën e Kaçanikut ata gjujshin, gjujshin disa punkte të ushtrisë, gjujshin disa tunele, ata policë e ushtarak. Babai i kishte disa miq, pasi që ai ka bashkëpunuar me aeroportin ushtarak, pastaj kishte miq nga ata personelët ushtarak, ata “Jo, njeri mos shko!” Ashtu në kuptimin e asaj që nëse insiston aq shumë ne do të sigurojmë kalimin për të arritur deri, deri, deri, pra deri në kufi me Maqedoninë.

Ne arritëm te kufiri i Maqedonisë dhe njeriu na shpiu te kufiri. Njeri të gjallë nuk kishte, si në filma amerikan, në, në, Las Vegas bukvalisht kur sillet ai bari, nuk ka një njeri të gjallë, asgjë nuk punon, dhe ai neve na thotë, “Nuk mund të kaloni duhet paguar një taksë administrative për kalim përtej kufirit” dhe thotë, “ju nuk e keni atë”. “Ku duhet paguar atë?” Aty askush nuk punonte, shteti në gjendje të jashtëzakonshme. Pastaj, “Jo, jo, ashtu sikur nuk mundeni”. Kur u kthyem mbrapsht, në Kaçanik na pritshin disa, disa, disa paramilitar, nuk e di, nuk kam lidhje, njëri prej tyre ia drejtoj babës mitrolezin, në kuptimin, “Ku je nisë ti, ku shkon? Ti do ta lëshosh Kosovën e ne po rrijmë këtu për ta mbrojtur Kosovën.” E pranë tij e ulur gruaja lehonë me foshnje një muajshe, si ta them...

Dhe hajde të gjitha këto i përjetuam, u kthyem për në Prishtinë dhe në një moment, mendoj tani, tani ti më ke futur në kujtime, sa janë përpjekur prindërit e mi të cilët janë naiv, tepër naiv. Në një moment, babai tha, “Po ka edhe një mundësi që të shkohet në Shkup, me tren”. Edhe ne, “Po, hajde!” Ne të vegjëlit nuk kemi udhëtuar kurrë me tren. E tani ai ndejti në Prishtinë, neve na afroji te stacioni i trenit, e me neve erdhi motra e nënës me dy fëmijë, une me tezakët e zëmë një kupe. U vendosëm në kupe na ishim shtatë apo tetë veta. Ne u bëmë tetë me Damirin e vogël, e treni u nis. Në ndërkohë, në një vend jashtë trenit, jashtë stacionit diku kah Fushë Kosova pritshin një masë...

Vërtetë ne kemi qenë në Fushë Kosovë, në stacion të trenit pastaj në vazhduam për Prishtinë për t'i mbledhur edhe disa udhëtarë, në një moment, lumi i njerëzve hyri në tren. Kështu pra u mbush me nëna dhe fëmijë shqipëtarë që flinin nëpër koridor. Do të thotë, aty ishte turmë e madhe dhe nuk kalohej deri në toaleta. Treni u nis, mbërrijti deri diku, ndoshta në Lipjan, dhe këtu u ndalë. Ra muzgu. Në këtë moment shoh shtëpitë anash në flakë e gjithkrah përreth. Treni i ndaluar nuk lëvizë, asgjë nuk ndodh. Njerëzit kërcenin nga treni. Policia i kthente në tren me dhunë. Ai tren ka shkuar deri në kufi të Maqedonisë dhe aty ndaloi. Pastaj të gjithë dolëm jashtë. Ne jemi, unë po them se prindërit e mi janë

shumë të virgjër, ata mendonin sikur kur kemi shkuar në Beograd, Novi Sad dhe atje na pret gjyshja dhe gjyshi në stacion të trenit në Shkup. Treni u ndal në kufi të Maqedonisë dhe thanë, “Dilni jasht!”

Marijana Toma: Policia, apo?

Samir Sezairi: Policia. “Dilni jashtë!” Dhe na thanë se duhet ecur nëpër binarë. E minuar është çdo gjë përreth binarëve. Tani nëna ime mbante foshnjën një muajshe, ne fëmijët prej dymbëdhjetë vjetësh, nëndë, ndërsa ata tezakët i kanë përafërsisht vitet si ne. Lumi i njerëzve që ecnin nëpër binare. Në një moment arritëm në kufirin e Maqedonisë dhe thanë që policia e tyre është, ata zbritën nga lartë. Ata nëpër binarë erdhën e ju drejtuan nënës sime me bebe në dorë. Nana ime e flet maqedonishtën, ajo e ka përfunduar shkollën në gjuhën maqedone, dhe asaj i thanë, “Zojë, ku?” Ajo tha, “Po mua më pret babai dhe vëllau” Ata i thonë, “Po mirë. Ju ejani lartë për t’u ngrohur.” Ishte ditë e muajit mars, mendoj ftoft ishte. Ai tha, “Ejani lartë për t’u ngrohur, atje në stacion të policisë.” Ajo tha, “Por unë i kam edhe dy fëmijë.”

Mendoj, neve na llogarisnin si djem të vegjël që përjetuam atë, por nga kjo perspektiva e një nëne e cila është e vetme me tre fëmijë, kjo e bënte një gjendje shumë të rëndë. Në ndërkohë erdhi tezja dhe fëmijët. Ata filluan të na thërrisnin nga stacioni policor. Gjyshi dhe daja na prisnin në stacionin e trenit, pra ishte ky moment, treni shkonte deri në stacionin e trenit dhe ne dalim si zotni dhe ata na presin. Ata thërrisin te ata në shtëpi, “A e dini që vajza e juaj është te ne në stacionin policor në kufi?” Pastaj ata erdhën me veturë, ne shkuam te ata dhe në këtë mënyrë ne u vendosëm në Shkup.

Pastaj erdhëm në Beograd menjëherë në ‘99-tën sepse mendonim të bashkohemi të gjithë këtu. Baba e kuptoi menjëherë se është vështirë të qëndrojmë në pikëpamje ekonomike, ishte e pamundur për momentin, nëna nuk punonte në atë kohë. Mendoj ajo punonte, e kishte një pagë mirëpo nuk i përmbushte kërkesat me tre fëmijë, dy vijonin shkollën, pastaj për foshnjën duhej... qiraja e banesës... Rreth tij ishin vetëm kërkesa, nevoja të mëdha, punonte në Zemun, ndaj ai mbeti në Beograd, por shkonte në relacionin Beograd-Prishtinë. Pastaj ne, thënë kushtimisht, mbetëm në Shkup prej ‘99 deri në vitin 2004. Sado që duket traumatike, për neve ishte fat, ne e kemi pasur fatin po e përseris ishte me rëndësi që e kishim dikend që i njihje gjuhët, ajo ishte nëna ime e cila fliste gjuhën maqedone si gjuhën serbe, atje e ka kryer shkollën, fliste shqipën si gjuhën serbe, por mund të them se të tjerët nuk e kishin të njëjtin fat, kushtimisht po e them. Andaj ata kanë përfunduar nëpër kampe, atje, larg 15, 20 kilometra prej Shkupit, dhe ne jetuam në qendër të tij.

Shumica e atyre njerëzve e ka lëshuar Maqedoninë, sepse kanë marrë viza për vende të Evropës të cilat i kanë pranuar refugjatët. Pjesa dërmuese është kthyer prapa pastaj, duke menduar se po kthehen në një tokë të shenjtë, në Kosovë, ndërkohë mendoj se e kuptuan nga kjo perspektivë, ishin më të vetëdijshëm se doli edhe më keq. Një pakicë njerëzish iu doli më mirë por shumicës së njerëzve të, të singertë jetën e kishin më të vështirë sepse jetojnë në një shtet i cili është i paformuar, merre si të

duash. Por kishim mundësi që të shkojmë në Australi, daja i nënës jeton në Australi, prej '68-tës apo '70-tës. Pastaj dy të tjerët kanë shkuar në vitet e '90-ta, kur ishte lufta në Bosnje.

Marijana Toma: A kanë jetuar ata në Kosovë?

Samir Sezairi: Po, ata kanë jetuar në Kosovë, por jetonin në fshat. Ata kanë jetuar në ato lartësitë, sipër Prizrenit, kanë shkuar në vitet e '90-ta, kur ishte lufta në Bosnje, atëhere shkuan. Nuk e di si por ata e kanë bërë kërkesën dhe kanë aplikuar për viza, së pari kanë shkuar në Bosnje dhe pastaj ideja që prej Bosnjes është e mundur të mirret viza, pastaj ashtu edhe vepruan dhe shkuan në Australi... Nëna ime ishte për shkuarje, "Do të shkoj pa ty", pa babain tim, në atë kuptim, "nëse ti nuk do të vish". Babai im ishte i lidhur ngushtë me nënën, ishte fëmijë i prindërve të ndarë, prandaj është i lidhur shumë me nënën. "Nuk mund ta lë ate dhe pasurinë e patundshme, çka do të bëjmë ne atje?" Shikuar nga kjo perspektivë, muret nuk mundet askush me t'i marrë. Nëse do i rregullosh dokumentet kjo nuk është fare e rëndësishme, por shikuar nga perspektiva e tij, sa kohë është munduar, sa ka punuar për të na rregulluar jetën dhe kushtet më të mira. Unë atë e kuptoj pse e ka marrë atë vendim që të mos shkojmë. Nëna nuk ka mundur të vendos që të shkoj me tre fëmijë, veçanërisht me atë bebe të vogël, shumë të vogël.

Sikur të shkonim në '99-tën ne do të shkonim pa probleme, pastaj ajo ka aplikuar në vitin 2001. Kjo për atë ishte një traumë serioze. Ajo në atë rast ishte e prerë dhe tha, "Nëse ti nuk do të shkosh, unë do të shkoj me fëmijët. Ti mund të vijsh kur të duash. Nëse vërtetë dëshiron të vijsh në Australi, nëse ke dëshirë të vijsh". Në ndërkohë gjatë vitit 2001 situata ndërroi plotësisht. Ne kemi mbetur në Shkup, e kishim fituar një lloj statusi, ishim në njëfarë forme afër procesit që të fitojmë nënshtetësinë, por e kishim statusin e refugjatëve.

Kështu, shqiptarët u kthyen në '99-tën në Kosovë, e tani në Shkup erdhi një pjesë e serbëve dhe të tjerë si refugjatë. Nëna ime aplikoi për vizë të Australisë. Ajo nuk ka mundur më të qendroj, thjeshtë... Aplikoi për vizë të Australisë, daja ia dërgoi dokumentet dhe i tha kështu, "E ke garanconin në letër, nuk e di sa të sukseshme do t'a kesh aplikacionin". Pasi ajo dinte gjuhën angleze, ajo i plotësoi vet ato formularët, të gjitha i ka sqaruar aty, por në ato dokumente shkruante, "Na tregoni konkretisht, pse nuk mund të ktheheni në Kosovë e Metohi?" Konkretisht, jo arsyet e përgjithshme. Fakti që ju folni apo nuk folni gjuhën serbe, ate pse ju nuk mundeni të vijoni shkollën në gjuhën serbe, pra këto janë të përgjithshme e jo ... nuk, nuk janë konkrete.

E tani ne ishim në situatë kur nuk mundeshim ta dëshmonin ndonjë arsye konkrete, pra pse ne nuk mund të kthehemi, përveç ate se ne nuk mund të flasim gjuhën serbe, e te shkojme shkolla serbe, thjeshtë, ata neve na kërkonin arsyet konkrete, "Pse ju nuk mund të ktheheni?" Motra e nanës e cila ishte një vit më e vjetër se ajo nuk kishte dëshirë të shkoj në Australi, asnjëherë. Tezaku im i cili është prototip Ballkanas që të thotë, "Fol serbisht që të kuptoj e gjithë bota". Madje edhe në Maqedoni, pasi edhe ai ishte në Maqedoni, ai flet serbisht. Thoja, "O njeri, nuk mundesh kështu, ti nuk i respekton

njerëzit”. Mendoj, nuk është gjuhë kineze, por edhe sikur të ishte gjuhë kineze e mëson të paktën sa për komunikim. Thashë, “Kape e mësoje sa për komunikim”. “Po, jo bre, mua të gjithë më kuptojnë”. “Po, por...” i thashë, “ti nuk po i respekton ata”. Domethënë, kjo është...

Unë kam dëshirë të shkoj në Kosovë, me këto sa i di, afër njëzetë fjalë, unë atyre bukur ju them në gjuhën shqipe, “Mirëdita, ditën e mirë dhe falemnderit shumë!” Pastaj ato që nuk i di u kërkoi falje, unë kaq di, por i respekton. Pastaj ata të arsyetojnë, kuptojnë se ti po i respekton dhe nuk ka asgjë negative, situata është në rregull. Nëna e plotësoi, për shembull atë aplikacionin për vizën e emigrimit. Tha, “Ja, hajde po ta plotësoj unë. Hajde nuk ka lidhje do provojmë”. Por këta e kishin arsyen konkrete, me atë pyetje të theksuar, “Konkretisht thuaje pse nuk mund të ktheheni?” Vëllau i tezakut ka punuar në polici, prandaj nusën e tezakut në vitin ‘99 e kishin gjuajtur më armë. Do të thotë, ajo i ka pasur disa plagë në trup. Gruaja ka qenë në rrugë. Vetëm sa ka dashur të hyj në automobil, ate e kanë gjuajtur me armë, por ka mbijetuar, për fat nuk e ka pasur të lënduar asnjë organ vital, nuk e ka pasur të dëmtuar.

E tani kjo këtë e ka paraqitur natyrisht në polici, ata e kanë këtë në dokumentacionin e tyre dhe këtë rast e evidentojnë si arsye konkrete. Sepse, nuk e di, një anëtar i familjes sonë ka qenë i goditur apo diçka e tillë. E tash për vizën australiane është specifike nëse ata të thërrasin, nëse ta dërgojnë e-mailin prej tyre, se kur ata ta dërgojnë, përafërsisht të thonë, sikur “Ne dëshirojmë të bëjme një intervistë me ju”, kështu po. Domethënë, po e them kushtimisht nuk e di që, a ka një përqind të njerëzve që janë të refuzuar në këto raste pas intervistës. Edhe ata që nuk kanë pasur dëshirë të shkojnë në Australi, ata kanë shkuar. Dhe kështu, ata jetojnë në Sidnej prej vitit 2001. Ndërsa nëna ime ka përjetuar në ato vite traumë serioze sepse kjo farë përgjigje negative e goditi keq. Negative, përgjigje negative. Pastaj ka aplikuar diku pesë herë apo gjashtë për Australi. Dhe në fund ne nuk kemi shkuar.

Ata janë në Australi, super jetojnë, takohemi çdo vit me ata apo çdo të dytin vit kur ata vijnë këtu. Kështu, për dallim prej neve, ata akoma e kanë atë traditën, sepse para dy apo tri vitesh u martua motra, pastaj vëllau u martua e ata thonin, “Ne do t’ua gjejmë një gocë nga viset tona. E pastaj do të bëjmë darsëm në Kosovë, atje në jug”. Kanë bërë darsma disa kusheri në Australi, ata jetojnë në Australi nuk mund të vijnë, një darsëm atje edhe një tjetër darsëm për ata që kanë mbet atje, kështu që...

Ne kemi ardhur në Beograd krejt rastësisht në 2004-tën, dhe mendoj kjo ishte ide e mirë e babës tim. Sepse ai veç ishte në Beograd, këtu veç e kishte krijuar një lloj baze, një temel për të gjitha këto. Unë kam ardhur në vitin e tretë, kur e kam mbaruar vitin e tretë të gjimnazit, edhe pse në të vërtetë kam dashur të qëndroj edhe një vit. Motra ime sa e mbaroi klasën e tetë dhe erdhi, e kreu klasën e tetë në Shkup dhe pastaj erdhi edhe ajo në Beograd u regjistrua në gjimnaz. E une kam pasur dëshirë të qëndroj edhe një vit. Megjithëse, shikuar nga kjo perspektivë prapë mendoj se më mirë që kemi vendosur kështu, sepse për një vit unë e mbarova, e njoftova qytetin, i njoftova disa njerëz bukvalisht sikur të kisha jetuar gjithmonë këtu, pastaj u regjistrova në fakultet, pa asnjë problem për adaptim në mesin e ri. Unë këtë e përjetova një vit më herët në shkollën e mesme.

Marijana Toma: Në cilin gjimnaz je regjistruar?

Samir Sezairi: XII.

Marina Toma: Aaaaa, shumë mirë.

Samir Sezairi: Gjimnazi XII, e ne jemi e treta, Damiri është gjenerata e tretë në familje i cili e ka mbaruar Gjimnazin XII.

Marijana Toma: Bukur, kush ju ka dhënë histori?

Samir Sezairi: Sonja Erceg.

Marijana Toma: E Erceg, mirë, nuk ju dha?

Samir Sezairi: Jo, Sonja Erceg, po Sonja Erceg ishte. Unë te ajo e kam pasur notë të dobët në gjysëm vjetor, edhe pse e kam njohur lëndën për pesëshe. Edhe vet më thonte, “Ndëgjo, ti ke njohuri për pesë, por unë nuk mundem deri sa ta përmirësosh njëshin e gjysëmvetorit, unë nuk mundem me ta dhënë një notë më të lartë.” Por më ka tërhequr historia edhe ajo sa që...

Marijana Toma: Më thuaj tash, pra, ti vjen, po supozoj se keni jetuar në Vozhdoc, atje keni jetuar apo?

Samir Sezairi: Ne kemi jetuar në Bulevardin e jugut. Sepse unë kam qenë në gjimnazin e përgjithshëm në Shkup. Ndaj për mua ishte specifike këtu sepse më është dashur të gjej një gjimnaz të përgjithshëm, gjimnazi XII ka qenë i përgjithshëm, mirëpo gjimnaz i përgjithshëm, pastaj edhe e kisha, shumë, shumë afër. Në ndërkohë kaluam nga Vraçara në Vozhdoc, e kisha në të njëjtën largësi por e kisha një lloj përvoje atë vit, atë *survival* [Eng.: mbijetesë] klasike derisa u adaptova në të gjitha sepse kisha vijuar mësimet në një shkollë në Shkup që ishte specifike, një shoqëri ndryshe dhe mirresha me një sport, pastaj, kisha disa beneficione e pastaj erdha këtu, në një klasë që është më e mira në shkollë. Jo vetëm në gjeneratë por në mbarë shkollën prej të parës deri në klasën e katërt, mesatarën 4.60 të klasës e kishim.

Marijana Toma: Si shkonte, si? Mendoj, si të dukej kjo, si të pritën ty? Ti që ke ardhur nga Shkupi, prapë ti madje gjuhën amëtare e ke pasur serbishten, natyrisht, cilado nga këto gjuhë e tonë. Si të dukej ty? A kishe ndonjë lloj përvoje, kështu?

Samir Sezairi: Po për ata ishte diçka specifike, ka ardhur njëfarë Maqedoni.

Marijana Toma: (E pakupt.)

Samir Sezairi: (E pakupt.) sikur. Dhe më kujtohet një profesoreshë e gjuhës serbe që më tha, “Sa e ke pasur ti në gjuhën serbe në Maqedoni?” I thashë, “Po unë serbisht nuk kom pasur në Maqedoni.”

Marijana Toma: (E pakupt.)

Samir Sezairi: Por unë kam ardhur nga një shkollë ndryshe dhe e kisha një lloj averzioni ndaj Beogradit. Unë kryesisht kam pasur averzion ndaj Beogradit. Por unë tani nuk do ta kisha ndërruar me asnjë vend në botë, për mua ky është qyteti më i bukur në botë. Mendoj, nuk kam problem të emigroj kudo, por për mua Beogradi është epiqendra e të gjithave.

Marijana Toma: E pse e kishe atë averzion?

Samir Sezairi: Po për arsye se sa herë që kam ardhur në Beograd mua më ka ndodhur diçka. Unë kam ardhur nga deti në Beograd, e kam përfunduar në spital. Njifarë infekcioni, një lloj ashtu... Unë kam ardhur në Beograd ashtu disi për t'u relaksuar ato shtatë ditë e mua më ndodhshin këto, duke përfunduar në spital apo ai Damiri i vogël sëmurëj... pra gjithnjë ndodhte diçka dhe mund të them se për Beogradin asnjëherë deri në vitin 2004 nuk kishim ndonjë gjë pozitive. Gjatë gjithë shkollimit tim në Shkup ishte ndryshe, ne jemi shoqëruar masovikisht dhe ishte një shoqëri vërtetë e mirë, unë kam luajtur voliboll për shkollën dhe i kemi fituar disa shpërblime shumë të rëndësishme që na mundësuan pjesëmarrjen në gara shtetërore. Dhe unë vërtetë asnjëherë gati nuk jam ndiertejmase i lodhur ashtu... nëna ime gjithmonë thotë, “Ti gjithmonë ke lozur me një lloj sharmi”, sa herë flasim për këtë tregim, “ti gjithmonë më shumë ke luajtur se sa që ke mësuar, gjithmonë ke luajtur”, kështu ishte.

Kështu që, nga shkolla e mesme e mora si një definicion që në këte mënyrë të kaloj nëpër ngritjen time arsimore madje edhe në fakultet. Jam përpjekur për aq sa kërkohej të përpiqesha. Pastaj unë e gjeta vetën në një mjedis ku të gjithë ishin nxënës klasik. Dhe te këta nuk ka një formë të... thërret profesori për t'u përgjegjur, të gjithë paraqitën vullnetarisht. Unë u pata shokuar, thoja, “O njerëz çka, çka bëni kështu?” Dhe sikur, “A ka njeri që do të përgjigjet?” Dhe prej tyre 35 vetave sa ishin, aty tetë prej tyre ngritën dorën për t'u përgjegjur. Tani një shoqe që ishte ulur para meje më tha, “Ti nuk do të paraqitesh?” Thashë, “Po më duket se jeni të mjaftueshëm, pse të paraqitëm unë tani?” Kjo ishte interesante. Unë kam shkuar vetëm në shkollë, unë shkoja në shkollë, pak isha në Beograd, ushtrimet dhe shtëpia.

Marijana Toma: Keni ushtruar voliboll apo?

Samir Sezairi: Unë nuk e kam mbajtur çantën e krahut, nuk e kam mbajtur çantën me libra, por e bajsha çantën sportive ku i kisha patikat, topin, përgatitjen time edhe librat, por unë e kam...Unë e kisha lënë pas vetës shoqërinë edhe vajzën, simpati që e kisha në Shkup dhe pastaj shumë me

vështirësi u adaptova në gjashtë muajt e parë. Edhe gjithë atë, atë shoqërinë time që e kisha në shkollën fillore dhe të mesme ata ishin të mbyllur, sepse ata nuk janë shoqëruar me klasat tjera gjithmonë thoshin, “Ja këta janë ata të marrët, shikoj këta...” ne ju themi *štrebera*², por për ata ishte diçka simpatike sepse unë jam dikush i ri aty, një njeri i ardhur. “Prej nga je?” “Nga Shkupi”. “Çka bën?” Ndërsa quhem Samir, ata mundohen t’i japin kuptim gjërave. Mendoj, njerëzit pak a shumë nuk janë të informuar, sepse unë kam një sërë njerëzish që edhe sot më dërgojnë urime për Kërshëndella, Pashkë dhe unë rregullisht ju përgjigjem, “*Hristos se rodi, Vaistinu se rodi*”, në gjuhën e tyre pa problem sepse unë këto gjëra nuk i konsideroj si provokime.

Sepse njerëzit nuk mendojnë, nuk janë të ngarkuar me ato gjëra apo nuk iu intereson ajo pjesë, andaj edhe dërgojnë, “Ej mik të kam, ajde edhe ti”, e ti pastaj ju thua, “Shiko unë këtë nuk e festoj”. “Auuu më fal të lutëm, nuk e kisha me qëllim”. Por në atë shkollë nuk e kishin problem derisa nuk filluan të na notojnë, eh tani... unë e mora njësh. Sepse akoma kisha nostalgjinë për Shkupin, për gjithë shoqërinë në shkollë dhe nuk isha shkarkuar bash mirë nga ata, ndërsa këta bënë gara kush do ta merr pesëshen, unë e morra njëshin dhe mua më thotë kjo vajza, kjo shoqja ime më tha, “Ti do të na e prishësh mesatarën e klasës.” I thashë, “Urdhëro?” Sikur, se...

Dhe kështu kemi filluar të shoqërohemi, e kishim të përbashkët një bazë, pastaj, këta që ishin *štrebera* filluan të shoqërohen atje, këta që janë sportista dhe mbaheshin, ndërsa, unë nuk kisha askënd as për kulturë fizike, nuk kisha shoqëri, sepse kam, sepse kam luajtur basketboll me ta, me vajza të them kushtimisht, sepse meshkujt ishin të limituar nga sporti. Prej 35 nxënësve në klasë, unë i kisha shtatë meshkuj, prej tyre njëri ushtronte për vallëzim, njëri ishte biciklist, ndërsa të tjerët nuk bënë asgjë, ashtu. Madje nuk e kishim as ekipin për futboll, në njëfarë rasti na plotësoi ajo shoqja. E na 29 vajza i kishim në klasë. Në një moment njena tha, “Qe unë do të mbroj nëse është nevoja për ekipin e klasës tonë.”

Kështu që, kryesisht unë nuk shoqërohem tani me, me, me, me atë, atë shoqërinë e shkollës. Mund të them se unë kam qenë një vit me ata. Shoqërohem. Shkojmë na.... Para dy viteve e kemi pasur dhjetë vjetorin e maturës e me tha nëna ime, “Çfarë bën ti në dhjetë vjetorin e maturës, ti ke qenë me ata vetëm një vit?” E pastaj shtoi, “Aha! E di pse ke për të shkuar ti. Do të shkosh të shohësh kush është atje, cila është martuar, a është martuar, cila është e lirë.” Thashë, “Po, pra nënë, tani është çasti më i mirë që të njihemi thelbësisht”. Madje për këtë edhe shkova. Por, shoqërohem tani ngase e kemi një lloj grupi, pastaj shkojmë në darka me këtë shoqëri që është në Beograd, por në përgjithësi unë e kam një shoqëri plotësisht tjetër, mendoj unë kënaqem kur i shoh, por nuk na ka mbetur një shoqëri shumë e afërt, mbase me një apo dy me të cilët mbajë kon...

Unë shoqërohem me Stefanin dhe me Savën, këta unë i kam shokë, këta i kam shokë nga Prishtina të cilët i njoh këtu. Mendoj, Savën e njoh që 27, 28 vite, por e kam takuar, por e kam takuar në shkollë, kemi qenë në të njëjtën shkollë, klasa pranë klasës, dhe ai e di që unë jam Samiri, më njeh nga

² *Štreber*, nxënës të zellshëm që aktivitetin kryesor e kanë mësimin.

Prishtina. Mirëpo, nuk mund ta bëj lidhjen me Samirin nga Shkupi, nuk e ka, dhe kështu më pas, kështu kemi vazhduar të shoqërohemi. Kështu që, shoqërinë nuk e kam të lidhur me atë pjesë të arsimimit tim, këta janë njerëz tërësisht nga ana dhe i kemi disa tema të përbashkëta dhe interesime të përbashkëta.

Marijana Toma: Ndërsa ti në vitin 2006 je regjistruar në fakultet?

Samir Sezairi: 2005.

Marijana Toma: Në vitin 2005 u regjistrove në fakultet, e pse shkencat politike?

Samir Sezairi: Unë gjithmonë kam qenë... mua shumë keq, gjithnjë më ka penguar padrejtësia.

Marijana Toma: Në çfarë kuptimi?

Samir Sezairi: Për arsye se për shembull, te ne në familje, axha im ka qenë anëtar i delegacionit serb në Pariz dhe në Rambuje në vitin '99, ishte anëtarë i PSS-së [Partisë Socialiste të Serbisë] dhe ne edhe sot e kësaj dite adhurohemi. Ai për mua është si një baba i dytë, por, meqë baba nuk është më, ne asnjëherë nuk flasim për politikë.

Sa herë që flasim për politikë, ne gjithnjë i kemi qëndrimet e ndryshme e pastaj grindemi lidhur me këtë pastaj nuk flasim gati dy javë e pastaj, "Dëgjo ti i ke qëndrimet tua, unë e respektoj këtë për arsye të ndryshme, pa marrë parasysh". Vërtetë unë përpiqem që njerzve t'ua respektoj qëndrimet jetësore, politike, fetare, e secilën që e kanë ta respektoj. Sa më konvenon mua apo jo, pastaj mu për këtë i kemi disa grindje, shpërthime. Mirëpo, i kam dashur lajmet qysh kur isha i vogël, iha ku më ke kthyer në ato, ato, ato, gjëra të vitit '99, ti dëgjon një lajm në orën 16:00, pastaj më vonë atë lajm plotësisht të kundërt në, në, në, një tjetër, një tjetër, një tjetër program, një tjetër televizion.

Përjeton atë që dikush ka përjetuar një padrejtësi, kanë përjetuar një padrejtësi të vërtetë. Këtu e kam fjalën për të gjithë sepse ne jemi dëm kolateral i një politike, politike të gabuar. Të gjithë ne që kemi jetuar në Kosovë, ne jemi të dëmtuar nga një politikë. Sikur të ishte ajo politikë pak më ndryshe dhe më e drejtë, të gjitha gjërat do të funksiononin ndryshe, sepse ato kanë funksionuar me shekuj.

Marijana Toma: (E pakupt.)

Samir Sezairi: Në atë mënyrë. Prandaj mua më kanë interesuar shkencat politike, në një mënyrë më ka tërhequr edhe ai opcioni qytetar edhe kjo, domethënë, kjo demokracia, këtë unë, shumë e kam respektuar gjithmonë. Unë asnjëherë nuk kam pasur, as që i kam lejuar vetës të kem probleme për shkak se unë jam Samiri. Mandje unë mendoj se kjo është një pasuri, pse ne jemi të ndryshëm dhe asnjëherë nuk lejoj që për këtë të ndjehem i mangët. Njerëzit thonë, "Po duhesh pak më shumë të

perpiqesh, duhet ashtu, duhet kështu...” por unë nuk e kam këtë ngase asnjëherë nuk i kam dhënë rastin askujt që të më thotë se unë jam më pak me vlerë sepse une jam tjetër. Unë me këtë nuk kam fare problem, themi në, në...

Një anekdotë ashtu interesante nga politika nëse mundem, se unë jam anëtar i Këshillit në Kuvendin e Komunës së Vraçarit pranë Partisë Demokratike. Edhe tani do të aprovohet buxheti për vitin 2016, Kryetari i Kuvendit, apo në të vërtetë zëvendësi i Kryetarit të Komunës është nga Kosova, anëtar i Këshillit nga Kosova, ortodoks natyrisht. E drejtori i një ndërmarrje është nga Kosova, pastaj, anëtar i këshillit i PDS, i vetmi është nga Kosova edhe unë jam anëtar i Këshillit në PDS nga Kosova. Dhe tani si ulemi në ato ulëse të anëtarve të Këshillit, në një moment mua më ishte aktivizuar mikrofoni.

Aprovohej buxheti, kryetarja e kuvendit tha, “Ju uroj të gjithëve! E aprovuam buxhetin për vitin 2016. Ju falenderoj shumë që keni votuar”. E tash unë këtë e kam thënë për vetëveten. Në atë moment unë thashë, “Po na bre njeri ia dhamë shqiptarëve Kosovën, e ju buxhetin e Vraçarit nuk po mundeni me aprovu”. E tani meqë mikrofoni ishte i lëshuar, aty ishin edhe mediat, aty ishin edhe grupet tjera edhe tash u kthyen kah unë dhe unë ju thashë, “Po kjo është një e vërtetë e madhe, se mos të ishim ne gjashtë veta nga Kosova, ju” i thashë, “as buxhetin nuk po mundeni me e aprovu në Vraçar.”

Por kur i shqyrtojmë argumentet a je ti, ku ta di unë, shiptar, a je ti *ćetnik*, a je ti *ustaš*, a Kroat, apo musliman, çkado që je, njerëzit nuk munden të ngjiten për këtë fakt sepse ty kjo nuk të prek. Sepse për Kosovë është definicioni, pa marrë parasysh a je ti serb, shqiptar, musliman apo, apo çka do, do thotë, ata që kanë ardhur në vitin ‘99 në Serbi, ata të gjithë kanë qenë *šiptar*. Dhe pastaj, ndaluni njerëz, po si mundet me qenë Sava im *šiptar*, në kuptimin që të gjithë festojnë festat e njejta, a e dini kështu e kanë futur në kokë dhe thonë, “Ja erdhën këta *šiptar* të Kosovës.” “Ok, jemi *šiptar* nga Kosova? Ateherë ne do të jemi *šiptar* nga Kosova të cilët votojnë në Vraçar, pa ndonjë problem.”

Pra kur i sfidoni këto argumente, pastaj njerëzit nuk mund të mbahen për to. Sepse ata më pas mund ta vërejnë që je i arsimuar apo nuk je, që kjo të jetë vlerë e mirëfilltë apo dobësi për të cilën mundohen të kapen, dhe kjo prej nga jemi ne, ai argument është sfiduar qysh në fillim, dhe unë këtë problem nuk e kam pasur, kështu që, si te them...

Marijana Toma: Më thuani si ka qenë të studijosh në Beograd? Domethënë, tani e përmende këtë, se njerëzit të cilët kanë ardhur aty nga viti ‘99, shpesh ka ndodhur hajde ta themi që jeni ballafaquar me pengesa, me një lloj, mendoj, mendoj me një sjellje të tillë që ka paraqitur rezistencë. Ti ke ardhur nga Shkupi, ti tani e ke regjistruar Fakultetin e shkencave politike, i cili është njëri nga fakultetet më prestigjioze në Beograd. Aty vijnë njerëz, të them kushtimisht, i takojnë elitës. Si të duket kjo ty, të themi kushtimisht, pa marrë parasysh që ti ke pasur një vit për t’u adaptuar, të themi kushtimisht, për një *outsider* [Eng.: i huaj]?

Samir Sezairi: Po, por asnjëherë nuk e kam përjetuar atë në fakultet, themi atë, atë lloj pakënaqësie për shkak se jam... Madje në njëfarë mënyre ishte, “Uaaa, ai është nga Kosova.” Dhe pastaj luan me atë lloj sentimentit, “Uaaaa ne kemi ardhur nga jugu, e dini, ne e kemi vështirë” e tjera, por, në një mënyrë të themi kushtimisht kishim edhe një përparësi, ndoshta. Sepse edhe ata profesorë kanë qenë të arsimuar dhe njerëz që e kanë pasur këtë përvojë se kush është, nga është, nga cili rejon, ndaj e kanë këte mjaft...

Edhe kur më pyesin, “Aha, se ti je nga ai regjioni?” Sikur nga ai fshati, thjeshtë nuk e lidhshin mirë, ajo mua nuk më ka lënë përshtypje. Mendoj që në fakultet, në gjeneratën time ka pasur shumë njerëz që kanë ardhur nga Novi Pazari dhe qyteteve tjera nga Kroacija, Bosnja, por nuk ka ekzistuar ajo dozë e ndasisë. Madje as në atë, atë shoqëri nuk ka pasur ndasi aso... Ndoshta kjo është perspektiva ime, ndoshta unë e kam një perspektivë ndryshe, por unë e kam pasur super, të gjithë kemi qenë të ardhur nga diku, mirëpo shoqërohem, unë nuk e kam berë as vet atë dallim.

Përsëri unë po e them këtë, besoj se e kam marr nga familja. Prandaj kjo, ndaj ky është problemi im. Por nuk ishte kjo një lloj, një lloj, një lloj anomalie, them kushtimisht, madje unë ndonjëherë e kam shfrytëzuar si përparësi, që në emocionet, në emocionet dhe dashurinë për Kosovën do ta fitoj ndonjë poen, mos të them një notë me shumë. Por unë jam munduar të përcjell këtë edhe te motra ime, vëllau i im. Ndaj ne nuk e kemi këtë ndjenjë.

Damiri mbase e ka pasur më lehtë, sepse ai si Damir, ai ka mundur të kalojë nëpër çdo anë, në emocion them kushtimisht, mirë kjo vlenë edhe për motrën time edhe ajo mund të kalojë lehtë me emrin Sabrina, sepse këta emëra janë univerzal. Hajde emri im Samir, por unë edhe për këtë kam pasur sqarimin, por kur punoja... kryesisht në punë, kur punoja në firmë shtetërore dhe mirreshim dorëzimet e lokaleve afariste. Njëherë nga ndërmarrja publike erdhën disa njerëz dhe folëm kështu. Unë nuk kam akcent, së paku mendoj sqë nuk kam akcent dhe ne bisedojshim se çka duhet, si duhet e ata mua më pyetën, “Si quheni ju?” Ju thashë, “Samir” e ata mua... thashë, “Nuk ka lidhje zonjë, ky emri im ka evoluar. Me kohë përgjatë historisë prej Savës në Samir”. Kështu që, kur bën shaka në llogari të kësaj, atëhere i mbyl krejt, i jepni fund mundësisë që dikush të “Auu qe ky tash, nuk di, Samir apo sido që të jetë”. Kështu që, këto janë këto...

Drejtoresha ime ka pasur problem me mua, sepse unë asaj, asaj, asaj... ajo është e martuar me një musliman dhe shumë shpesh ka ndodhur që, që unë them se do kisha dëshirë të shkoja në pushim, tani kjo është firmë specifike shtetërore. Unë them, “Nga e hëna jam në pushim”. Ajo mua me thotë, “Nuk mundesh të shkosh në pushim”. Mendoj, natyrisht të gjitha më lejohen, kjo është një dozë e raporteve të mira që i kemi pasur dhe unë e shfrytëzoj këtë para klientëve të cilët vijnë për të marr me qira, ne i njohim, nuk janë njerëz të panjohur, unë i them, “Ti këtë m’i bën mua me qëllim edhe atë me bazë fetare dhe nacionale, ti mua po më injoron”. E tash njerëzit që janë anash ju duket e pakëndshme biseda, kur i dëgjojnë këto, sikur, “A po sheh çka po iu bën ajo?” E ajo është e martuar për musliman, të

gjitha, ajo i feston të gjitha festat, kjo nuk është [çfarë bëjmë] e njëmendtë. Dhe ajo thotë, “Po leje more budallën, këto m’i bën me qëllim, vetëm të më turpëroj para palëve”, kështu...

Kështu pra unë gjithmonë jam ai, ai argument i dallimeve, do të thotë e shfrytëzoj si përparësi, e jo si mangësi dhe kjo te unë gjithmonë kapasur sukses. Sepse une nuk kam pasur përvojë negative, në përgjithsi nuk kam pasur asnjëherë përvojë negative jetësore në Serbi. Dhe në këtë moment emotiv, unë gjithmonë në mënyrë shumë, shumë, shumë të sinqertë dhe të hapur e them. Nëse kemi probleme të këtij lloji në start, do të thotë më mirë mos të hyjmë këtyre raporteve, sepse përpjekja, energjia dhe emocioni që do të investojë në këtë, nuk deshiroj që pas tre muajsh të më thotë, “Hej shiqo kemi problem”, kinse...

Mendoj, çdonjëri nga ne e di dhe e ka të qartë në kokën e vet çka dëshiron, çfarë dhe në ç’drejtimit i ka udhëzuar familja, a e ka familjen fetare, apo nuk i ka fetar, se sa i pranojnë ndryshimet apo jo?! Por të jemi të sinqertë, mundemi edhe më tutje të shoqërohemi, mund të jemi edhe miq, po, mund ta vizitojme njëri tjetrin, të urojmë festat tona, por nëse nuk mundemi të ndërtojmë këtë raport emotiv atëherë më mirë që të mos futemi dhe ta shkatërrojmë edhe këtë shoqërim i cili mbase është i sinqertë. Kështu që, këtë lloj eksperience e kam pasur, por po them shumë, jam shumë i sinqertë në fillim dhe e di se kjo më vonë nuk të lëndon. Kur zhvillon ndjenja ndaj dikuj, në këtë rast pas tre muajsh, katër, gjashtë, sikur... Prandaj kam thenë, sidomos në këto vite, “Njerëz bëhuni të sinqertë ndaj vetëvetes”. Do të thotë, së pari ndaj vetës pastaj ndaj të tjerëve, por gjithsesi së pari ndaj vetëvetes. A mund ta bësh këtë apo jo?! Nëse mundesh, ok hajde do të provojmë, nuk kemi garancion që diçka në jetë do të qëndrojë gjatë, por kjo varet nga ne. Por nëse kjo nuk mundet, pse atëherë e bëjmë.

Marijana Toma: Më thuaj, çfarë beën tani, me çfarë mirresh?

Samir Sezairi: Po tani punoj për, për një shtëpi të sigurimeve austriake, e cila, e cila punon këtu te ne, “Sigurimi Uniqa”. Pasi i kam përfunduar Shkencat politike dhe nuk kam asnjë lloj vegle tjetër përveç që të flas dhe plotësisht jam adaptuar këtu në këtë lloj pune në Shoqatën e sigurimit. Punoj, punoj në sektorin e shitjes dhe nuk mund të ankojem, për mua është super. Them... e dua, e dua për shembull Vraçarin i cili është specifik ashtu, edhe pse nuk jam Beogradas, nuk jam dhe jam regjistruar në Vraçar, unë lejen e njoftimit e kam në Vraçar, dhe nga kjo është... anëtar i Këshillit jam këtu, thjeshtë në Vraçar ndihem mirë emocionalisht sepse... për shumë arsye, dhe kam punuar këtu. Unë zyren e kam pasur këtu në vazhdim të komunës së Vraçarit, nga ana tjetër, njerëzit të cilët jetojnë këtu janë normal. Tash them, a është kjo përparësi, por vërtetë Vraçari është më i shtrejt, më i pasuri, më i arsimuari, por të gjitha këto të tërheqin, e sidomos fakti që këta njerëz janë normal.

Edhe këtu, në këtë, në këtë rrugë ku jemi tani, kjo është njësia ime zgjedhore dhe pastaj unë njoh njerëz. Kështu, e kam zakon që të kalojë pranë një ndërtese e t’i bie ziles në interfon të shtëpisë, të pyes se cilët i kanë votuar, cili votoi për mua apo vetëm sa për t’i pyetur, “A jeni gjallë?” Bash kur

kalojsa nga kjo anë dhe parkojsa në anën tjetër të rrugës, këtu në Krunska, shkoj te ky zotëria dhe zonja gjithmonë, ata sikur i kam votues të sigurtë. Unë vetëm po i thërras dhe pyes, derisa ishte zotëria gjallë ai thoshte, “Tomislav, a jeni gjallë?” E ai thotë, “Jam, jam, hajde për një gllënk raki.” Thojsha, “Nuk mundem tash, jam vetëm në kalim”, i thojta, “do të vi një herë tjetër”.

Kështu gjithmonë i mbaj këto komunikime dhe nuk bëjë dallime. Më së shumti dëshiroj të flas me njerëzit e tregut, këto i di se në pazar, ate e di që prej shitësve, stërshitësve deri te keta që shesin gjëra e deri te, deri, deri të ata që shesin pemë e perime dhe ata që i pastrojnë rrugët. Për shëmbull, ata i kam më simpatik, se me ata mund të flasësh, nuk bëjë ndonjë dallim, thjeshtë, nuk bëjë ndonje dallim, a je ti kryetar komune a, ai është thjeshtë njeri i cili punon për ndonjë dinarë. Ndaj gjithmonë ndalem e flas me ata, sa e kanë pagën, kur do të marrin pushimin? Njerëzit më përshëndetin në rrugë. Ky pra është Vraçari... Vraçarin kjo e bënë specifikë, prandaj e dua, sinqerisht sepse të gjitha janë këtu disi...

Marijana Toma: E si të ka ardhur kjo ide, si të ka ra në mend që të angazhohesh në politikë? Kjo tani po më intereson. Pse e bëre këtë?

Samir Sezairi: Po, gjithë ky, gjithë ky tregim rreth asaj Kosove dhe atij dëshpërimi dhe e gjithë ajo është ide, vet ideja e regjistrimit tim në Fakultet të Shkencave politike të përcakton në njëfarë mënyre nëse e ke ndërmend që të ndërrosh diçka, të inkuadrohesh dhe që aktivisht të kyçesh. Në këtë lloj momenti janë të lidhura të gjitha, ajo, energjia që e ka pasur, për shëmbull Zoran Gjingjiq, kur ishte kryetar i Partisë Demokratike dhe si një njeri që është munduar me sinqeritet që, që, që këtë shtet ta çojë përpara, si shëmbull i të rinjëve, politikës humbëse e cila ishte viteve të ‘90-ta dhe të gjitha ato luftëra, inflacioni dhe nuk kam ide, refugjatët që vinin nga Kroacia në Kosovë, me të cilët ne mbajshim do raporte disa prej tyre kanë punuar te nëna ime në spital.... Mendoj për ata njerëz se që kanë qenë më të ndershmit, njerëz të mirë. Serbët nga Kroacia, pastaj statistika e ka dëshmu se ata kanë qenë njerëz më të arsimuar në mbarë Jugosllavinë.

Dhe kjo mua më ka nxitur plotësisht në këtë drejtim. Nuk më ka shtyer, por disi une e kam pasur një lloj dëshire që, që, që të kyçem disi në të gjitha këto dhe kjo Partia Demokratike ka qenë përzgjedhje logjike për mua, përcaktim logjik, sepse ato vlera që i ka shtruar, demokracia, opcionet qytetare, respektimi i llojllojshmërisë së pakicave kombëtare dhe të gjitha së bashku në një moment në vitin 2006, atëherë kur unë jam anëtarësuar nuk e kam pasur një fije dyshimi. Në lojën e rastit, kështu, ishte një djalë i një mikut familjar i anëtarësuar në Partinë Demokratike, se ai është pak më i vjetër se unë, edhe ai ka qenë në Vraçar. Kështu, ky është thelbi i kësaj ideje se si unë përfundova këtu në Partinë Demokratike në Vraçar, edhe mund të them se asnjëherë nuk jam penduar për këtë madje as edhe tash kur ai opcioni politik nuk është më i popullarizuar. E edhe kur ishte Partia Demokratike në njëfarë niveli kur është afër censurit apo nuk është afër censurit, unë jam gjithmonë për... unë po e theksoj pasi që nuk kam ndonjëfarë dobie nga ajo.

Do të thotë, absolutisht nuk kam ndonjë, as interes material, as ndonjë lloj satisfakcioni tjetër sepse vërtetë besoj në idenë e tyre, ideologjinë, dhe besoj në politikën lokale. Asnjëherë nuk më ka pëlqyer që të mirrem me politikën qendrore, sepse politika e nivelit qendror nuk ka qasje të vërtetë në qytetarë. E politika e këtij niveli është jashtëzakonisht interesante sepse je në kontakt dhe në komunikim me qytetarë, sikur ti edhe une tani. Dhe mundesh të vendosësh të zgjedhësh probleme të qytetarëve, në këtë nivel, por nëse nuk ke qasje në ta, ti nuk ke kohë më për ata dhe e ndien vetën jashtëzakonisht në nivel të lartë dhe të rëndësishëm.

E në këtë nivel, e thërret në interfon dhe pyet Tomislavin, “A jeni gjallë e mirë?” “Jam, ku je? Hajde në një raki”. Pastaj të pyet, “A të duhet diçka?” Më duhet, nuk kam vend në parking para ndërtesës apo ashensori nuk është në rregull ose fasada e keqe ose fëmijët më shkojnë në shkollë ku nuk kanë mbikqyrje me kamerë. Këto janë probleme reale të qytetarëve dhe këto mund t’i zgjidhësh. Nuk mund t’a punësosh askënd por mundesh t’ua sigurosh zgjedhjen apo kushtet elementare për një jetë dhe kushte kualitative të cilat janë në domenin e komunës dhe të gjitha të tjerat, por më e rëndësishmja është se duhet të komunikohet drejtpërdrejtë.

Marijana Toma: E ne me ngadalë po i afrohem fundit, unë vërtetë kisha dashtur që t’i parashtrojë edhe dy pyetje. Nëse eventualisht ke edhe diçka të ndash me neve, të cilat gjëra ndoshta nuk i kam përmbledhur gjatë pyetjeve. E mua po më intereson një gjë, ti e përmende se para se të angazhoheshe në politikë e ke pasur një rën nga arsyet edhe Kosovën.

Samir Sezairi: Po.

Marijana Toma: Sa e mbanë në mend tani? Çka është Kosova për ty tani?

Samir Sezairi: Po... nuk kam unë emocione, kurfarë sentimente ndaj Kosovës për atë kohë në kuptim të... unë kam pasur... atë mendim se ata njerëz që jetojnë në jug, se mua më jetojnë xhaxhallarët edhe një numër i madh i kusherinjëve atje në Kosovë. Unë vetem kisha dëshiruar që ata të bëjnë jetë normale dhe të jetojnë jetë më kualitative. A do të quhet ajo pjesë Kosovë, a do të bëhet Krahinë Autonome, apo do të bëhet një shtet i tretë, mua... vetëm të kanë një jetë kualitative. Sepse kjo është esenca kur të ndalesh dhe të mendosh, mendon për atë se çka flitet në televizion, pastaj fillon të mendosh me stomak, kjo është esenca, e kjo do të ndodh herëdo kurdo, kjo duhet të ndodh.

Unë para tre vitesh kam qenë në Kosovë, isha në Prishtinë, në një komunë, kisha nevojë të shkoja në komunë, me duhej t’i nxjerrja disa dokumente nga Kosova për punë të patundshmërisë që e kemi lënë në Kosovë si trashigimi nga baba im. E mora taksin prej stacionit të autobusave, prej stacionit të autobusave te rrethi atje, prej Prizrenit kam ardhur me autobus. Unë hyra në veturë dhe i thashë atij “Mirëdita!” Edhe ai po më shikon ashtu, ishte i vjetër rreth të 50-tave, pastaj i thashë, “Më dërgoni në komunë” në gjuhën serbe. Tash ai asnjë gjë nuk e kishte të qartë. Thashë, “Unë nuk di më shumë

shqip, nëse mundeni ju lutem.” Ai tha, “Nuk ka problem” e tani filluam të flasim diçka, unë i thashë atij, “Sa të bukur e keni këtë Kosovë.”

E provokova natyrisht. Ai tha, “Si po mendon bukur?” “Po, bukur.” Thashë, “Më nuk ka serb, musliman asnjë tjetër”. Thashë, “S’ka si ndryshe, tani ju jeni shtet i pavarur.” Dhe ai njeri më tha kështu, “Mund të ju tregoj diçka shumë sinqerisht, po të i kishim pasur, kjo Kosovë do të kishte funksionuar më mirë”, tha, “deri sa ishin serbët, bajagi ishte njëfarë rendi, kishte njëfarë ligji, dihej pse paguhej tatimi, dihej që të shkon paga”, thonte, “e tani nuk dihet asgjë, tani një pjesë e popullit jeton shumë mirë e një pjesë e popullit vetëm sa për të mbijetuar”.

Unë po e pyes, “E ku ishit ju ne vitet e ‘90-ta?” Ai tha, “Unë kam jetuar në Zvicër. Ne fillim të ‘90-tave shkova në Zvicër”, e tha, “Erdha në ‘99 në Kosovë, duke menduar që tani do të bëhet [shtet]”. Edhe një numër i madh i popullit janë kthyer nga ato vende, tani ata e kanë fituar shtetin, tani ky është shtet i pavarur e tjera, si dhe do t’i ketë të gjitha të drejtat të cilat i ka pasur të mohuara. Pastaj, në ndërkohë jeta e tyre nuk ishte gjë më e mirë, madje mendoj se është edhe më e vështirë se sa që ishte. Nuk po them që jo, po ata kanë qenë të shtypur në njëfarë mënyre, por këta tash janë...

Ata e kanë një lloj vije të pajtueshme për gjëra kapitale, nëse ata kanë vendosur të bojkotojnë institucionet, të bojkotojnë shtetin, të bojkotojnë çdo gjë, ata të gjithë çohen i përkrahin. Do të thotë, derisa ne të tjerët nuk e kemi atë fare, këtu, nuk ekziston fare ai uniteti për gjëra kapitale, mendoj se njerëzit tonë do të na bëjnë të neveritemi me këtë Kosovë neve të gjithëve. Thjeshtë, ato çaste kur njerëzit e kishin plot gojën Kosova dhe gjithë ai patriotizëm, e asnjëherë nuk kishin qenë në Kosovë, kurrë nuk e kishin parë...

Për mua një moment ishte fascinant në atë, përsëri po kthehem në ato, në objekte fetare. Unë në Graçanicë, në manastir edhe tani po e shoh përmes atyre freskave ku shkruhen emrat Ana, Pera, Zhika ‘93, në hyrje aty ku janë freskat, ndoshta i ke parë. Nëse shkon, vini re, për shembull, nëse ti nuk e respekton njeriun tënd, si do të presësh nga të tjerët respekt, po respekto diçka tënden, nëse ti nuk e ke respektin. Por njerëzit, mendoj edhe ata të cilët kanë jetuar në atë Kosovë pas ‘99, pjesa më e madhe kanë jetuar më mirë pas ‘99-tës, se sa që kanë jetuar para ‘99-tës. Një grumbull i njerëzve që i njoh e që janë në Kosovën veriore kanë dalë, i kanë pasur banesat nëpër Beograd dhe atje i kanë marrë pagat e dyfishta, shtesat e fëmijëve, e ku ta di unë, disa bonuse e beneficione dhe e kishin plot gojën Kosovë. Kështu që...

E tani ti e përjeton atë që, ti dëgjon një dhe pastaj shkon dhe bukvalisht e shikon dhe thua ndaluni, e këta njerëzit nga jugu? Mitrovica e Veriut, Zveçani, krejt janë super, në rregull, shteti është këtu i lidhun direkt, jo indirekt, por Serbia direkt e lidhur në atë pjesë të Kosovës, çka, çka po ndodhë atje poshtë në Graçanicë, Shtërpce, enklava serbe, njerëzit nuk kanë, njerëzit nuk kanë bukë për të ngrënë. E ti plot gojën Kosova dhe ti e lë gjithë atë sasi të parave... Në Kosovë çdo ditë kanë shkuar nga një milionë marka deri ‘99-tën, çdo ditë i kanë derdhur milionat në Bankën Qendrore të Kosovës. E ti, ti plot gojën Kosova. E nga ana tjetër, hmm, edhe ata, edhe ata njerëz që kanë jetuar në jug, edhe ata janë pjesë e...

Ne si komunë i kemi mbajtur llogaritë si komunë e Vraçarit para tre vitesh, para dy vitesh në Lipjan. Lipjani ishte deri '99, monoetnik, gati qytet i pastër në të cilin jetonin serbët. Shkolla fillore "Kral Petar", mendoj kështu quhej, i kanë 250 nxënës dhe nuk e kanë asnjë mjet për llogaritje. Na ua dërguam dhjetë, tre apo katër llaptopa edhe shtatë a tetë desktope për llogaritje dhe na shtruan njerëzit një drekë. Ajo struktura paralele, ajo jeta e imagjinuar, jeta që njerëzit e jetojnë... Kryetari i komunës së Lipjanit i serbëve, kryetari serb i komunës së Lipjanit neve na shtroi drekë në Graçanicë, isha unë dhe me neve erdhi një djalosh kështu i moshës sime, ndoshta më i vjetër, i cili ishte aty nga rrethi i Graçanicës. Edhe tash sikur unë i di këto krejt i njoh gjeografikisht, e pyeta, i thashë, "Nga jeni ju?" Ai më tha, "Prej Gushtericës së Poshtme". Më duket apo diçka e ngjashme. Unë e pyeta tash a din, një pyetje timen logjike të radhës, thashë, "Çka ke nga pasuria? A keni shitur diçka?" E ai mua më tha, "Po ashtu, e kam shitur një, njëfarë parcele, njëfarë are që e kam pasur". Po i thashë, "Për sa e shite?" Tha, "300.000 euro".

Tash po mendoj 300.000 euro ke mundur të blesh tre, katër, pesë, gjashtë banesa në Beograd edhe ato t'i lëshosh me qira dhe të jetosh prej qirasë, e të kalojsh një jetë të këndshme, tani atë e mendoja. Unë e pyeta, thashë, "E çka, çka ke bërë me ato para?" Tha, "Po asnjëgjë, luajta komorë." Edhe më tha, "Jam në borxh 20.000 euro. Pastaj unë, i thashë vetëm këtë, edhe pse e pashë për herë të parë, i thashë, "Ti je kreten, ti qenke kreten". I thashë, "Ajo nuk ka qenë toka jote, kjo ka qenë toka e të parëve tu". Unë kurrë nuk e shes, ajo është e imja e kam në Kosovë dhe nuk e shes. Vetëm nëse do më nevojiten për ilaqe, apo për ndonjë investim, në fakt së pari do bleja një veturë, kjo asnjëherë nuk më ka interesuar, por...

Marijana Toma: Mirë nëse ke ndonjë gjë që të është kujtuar eventualisht që unë nuk të kam pyetur apo, mendo eventualisht diçka para se ta mbyllim intervistën, unë i kam ndoshta një apo dy pyetje. Kjo që flasim tani, kjo më inspiroi për pyetje të tjera. Ti ke thënë atë se në çfarë mënyre vërtetë njerëzit flasin më plot gojë për Kosovën dhe askush konkretisht nuk bën asgjë ose as që kanë qenë atje apo diçka. Duke e marrur parasysh se ti ke studiuar në kohën kur kanë ndodhur ngjarje të rënda politike, ngjarje lidhur me Kosovën, dhe se i takon një gjenerate e cila e mbanë në mend Kosovën, por në një mënyrë specifike përsëri e ke një lidhshmëri me të... Sa e mbanë në mend atë periudhë të Kosovës dhe a të përputhet në ndonjë mënyrë me rrethin tënd, si e komentojnë ata në rrethin tënd edhe pse nuk e kanë përjetuar direkt, nuk janë të lidhur më Kosovën, në të vërtetë shiqojnë dhe mbajnë në mend Kosovën apo mbase nuk e mbajnë në mend fare?

Samir Sezairi: Po ashtu, ashtu është, për këtë unë i kam shembujt më të mirë, gjithmonë shembujt më të mirë, pasi që i marr dhe i çoj në Kosovë, sepse ai është përjetim, përjetim i vërtetë. Këtë, këtë që ne dëgjojmë përmes të TV-së, e shofim... ajo është ajo variantë, më pas dëgjojmë ku di unë tani se në një vend, bomba shpërtheu në Mitrovicën Veriore, apo po dëgjohej të shtëna në Mitrovicën Veriore, apo ku ta di unë. Sipas një definicioni, ne e pranojmë se këtë e kanë bërë disa shqiptarë për shembull.

Sipas definimit e pranojmë, ashtu e paraqesin dhe kjo këtu përfundon, në TV kjo përfundon këtu pastaj askush nuk e demanton se paska qenë një përlëshje në mes disa familjeve për shkak të një pasurie, të definohen gjëra dhe ato kanë qenë Jovanoviçet dhe Petroviçet ndërsa njerëzit i përceptojnë ashtu sipas TV dhe sikur, aha! Sikur të tilla ka në mes shqipëtarëve, ashtu sikur përsëri po i sulmojnë serbët. Nuk e them se kështu nuk është ngjarja, por nëse kjo ka ndodhur, kjo është gënjeshtër e cila është përsëritur shumë herë dhe bëhet si e vertetë.

Marijana Toma: (e pakupt.)

Samir Sezairi: Kështu edhe kjo, e kjo sqarohet duke shkuar atje , duke e parë vet Kosovën.

Marijana Toma: Ku shkoni kur i çoni njerëzit në Kosovë?

Samir Sezairi: Në fillim i çojë në Prizren.

Marijana Toma: (e pakupt.)

Samir Sezairi: Për mua, unë bazën e kam në Prizren, kam qenë me shokun tim. Para tre apo katër vitesh, ishim ne të tre Sava, Stefani dhe unë, që të tre jemi nga Kosova, kishim mendime të ndryshme se si i shikonin gjërat. Ishim diku në esencë gati me përshtypje të njejta, por çdo njeri ka këndvështrimin, opinionet e vet, e kjo është, kjo është normale. Edhe i katërti i cili ishte me neve, ai është prej këtu, por origjinën e ka Ruse, ky asnjëherë nuk ka qenë në Kosovë.

Është tre, katër vite më i vjetër se unë dhe në atë kohë ai ka qenë deputet dhe tha, “Dua të shkoj, më merrni”. “Nuk ka asnjë problem, do të merremi vesh për këtë” e pastaj ajo frika në bisedë me prindërit e tij pasi që jemi miq, familjarisht shoqërohem. Pastaj nëna e tij më tha, “Kur keni qenë ju në Kosovë, ato pesë ditë unë nuk kam fjetur pesë netë, unë kam menduar që do t’u ndodhë diçka, çka po ju ndodh, kush e din çka kanë me ju ba.”

Mendoj se asgjë nuk na ndodhi, por kemi njoftuar njerez te ndryshem qe, qe, qe kemi ardh me një përvoje plotësisht pozitive. Kështu në teren i panë vlerat e verteta te asaj Kosove dhe kur shikojn tani e din tregimin e verifikuar, se nga gurët Shen Arhandelit është ndërtuar xhamia Sinan Pashës në Prizren dhe thon: “Eh kjo është shumë e mirë, sido qe, por kjo është tani historia dhe për kete ne nuk jemi fajtor, respektojmë, këte e ka ndërtu dikush tjetër, por e respektojmë këte si do qe te jetë kjo është kështu.”

Dhe kur ulemi në Prishtinë me zëvendës ambasadorin, zëvendës ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, djalin që i ka 35, 36 vite, i cili është me ngritje të lartë arsimore, i cili flet gjuhën serbe sikur të ishte nga Beogradi, dhe kur unë e pyes, sepse e kam njohur më herët atë, ai mbante një kafiteri në Prishtinë i cili ishte i tëri në, në, në, stripa, të ngjitura ashtu si tapeta. Une e pyeta, i thashë, “Më falë, të

lutëm desha të të pyes, si e mësove kaq bukur gjuhën serbe?” “Po,” më thotë, “unë jam rritur me gazetën argëtuese të Politikës.”

Marijana Toma: Si quhet ai?

Samir Sezairi: Jo tani e kam harruar, do të thotë e kam të regjistruar në telefon dikund. Por perfekt flet, baba avokat, nana i ka punuar në Bibliotekën Popullore apo në Muzeun e Kosovës, por rrinë në atë Prishtinë pas aq vitesh, parkon “BG” tabelat në qendër të qytetit, në parkingun publik dhe askush nuk të thotë asnjëgjë, porosit një pije. E, e, tani këto tregime bartën, e jo ato, që në Prishtinë nuk shkohet dhe nuk mund të flasësh serbisht apo nuk mund të shkohet në Dubrovnik. Edhe në Dubrovnik ty mund të të të ndodh diçka.

Mua asnjëherë nuk më ka ndodhur asnjëgjë. Ndoshta pse unë jam i tillë që nuk i barti ato energji negative as nuk i provokoj njerëzit në asnjë farë forme, por thjeshtë përvoja është e ndryshme, si dhe njerëzit e bartin atë përvojë negative, e ne jemi të prirur të bartim vetëm gjërat negative, në rastet kur dikush nuk na pëlqen dhe asnjëherë nuk themi asgjë pozitive.

Kam mundur edhe unë të them se unë nuk jetoj në Kosovë prej ‘99-tës edhe pse flas serbisht, shkoj në shkollë në gjuhën serbe ndaj me mbrojnë mua shqipëtarët, por atëherë po kthehem në fillim të tregimit të Halilit dhe po them, ai njeri është njeriu më i mirë i cili e ka treguar vetën në çastet më të vështirë, ka rrezikuar vetën për shkak meje, ai shqipëtar është njeri vërtetë i mrekullushëm dhe këtu pastaj bien të gjitha në ujë, e këto përvoja mundet individualisht çdokush me i bartë. Dhe kur dëgjon se një hoxhë është i korruptuar dhe hajn apo kur dëgjon se një prift po e ngarend nuk e di si quhen ato vetura BMW, audi, dhe e ka një kështjellë diku po argëtohen personat kishtar në këtë mënyrë pastaj shkon diku dhe i sheh vet i njofton, do të thuash, “Ndaluni bre njerëz, kjo kursesi nuk është siç flitet”.

Marijana Toma: E ke thënë një herë në një fjali dhe kështu kisha dashur në të vërtetë ta përfundoj, e ke thënë në një rast brenda një fjalie, në atë rastin kur tregove rreth ardhjes suaj prej Shkupit në Beograd dhe për Beogradin... kjo për mua ishte shumë, shumë interesante nisur nga fakti se ti ke jetuar në të gjitha ato vende dhe në të gjitha rastet ti ke thënë se ti nuk je Beogradas dhe tani nuk je... ke jetuar në Shkup, ke jetuar në Prishtinë, ke thënë se nuk i ki marrëdhënjet me asnjë vend si me Prishtinën, nuk e di si mund të jetë ajo më e rëndësishme, por tani... ku është shtëpia yte?

Samir Sezairi: Shtëpia ime është Beogradi, ndërsa unë jam nga Kosova. Shumë e vërtetë, sinqerisht. Unë gjithmonë e them. Asnjëherë nuk kam thënë se jam nga Beogradi. Nëse dikush më pyet, ndoshta mënyra e të folurit, ndoshta pamja ime apo veshja ime tregon se nuk jam nga Vranja apo nga ndonjë vend, pa dallim sepse kam respekt për të gjithë njerëzit, qytetet, por se Beogradi është qyteti më i madh, prandaj këtu ka ngjarje, ka ndryshime të mëdhaja kryesisht ndryshon moda edhe ndryshimet tjera nisen nga Beogradi, por unë gjithmonë ndihem që jam nga Kosova. Gjithmonë prandaj kjo kështu qëndron. Po unë jam, Vraçari i ardhur nga Kosova.

Marijana Toma: Super, faleminderit shumë Samir.

Samir Sezairi: Asgjë. Ju falenderoj dhe juve.